

ELEFANTI NË DHOMË

Një perspektivë profesionale dhe
“jo-politike” mbi trashëgiminë kulturore të
komunitetit serb në relacion me
trashëgiminë kulturore të Kosovës

Dhjetor 2020



Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi" i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada Gjermane në Kosovë.

Autorë: Nora Arapi-Krasniqi dhe Enes Toska

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: [HYPERLINK "mailto:info@kdi-kosova.org"](mailto:info@kdi-kosova.org) info@kdi-kosova.org

Ueb: [HYPERLINK "http://www.kdi-kosova.org"](http://www.kdi-kosova.org) www.kdi-kosova.org

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk paraqesin qëndrimet e Institutit Demokratik të Kosovës, Ambasadës Zvicerane dhe Ambasadës Gjermane në Kosovë.

ELEFANTI NË DHOMË¹

Një perspektivë profesionale dhe
“jo-politike” mbi trashëgiminë
kulturore të komunitetit serb në
relacion me trashëgiminë
kulturore të Kosovës

1. Shprehja “elefant/i në dhomë” (shprehje angleze) ose “elefanti në dhomën e ndenjes” (shprehje amerikane) është një idiomë metaforike në anglisht për një temë, pyetje ose diskutim të rëndësishëm ose të jashtëzakonshëm, çështje që është e qartë ose që të gjithë e dinë, por askush nuk e përmend ose nuk dëshiron ta diskutojë, sepse i bën të paktën disa prej tyre të pakëndshme ose është personalisht, shoqërisht, ose politikisht e turpshme, e diskutueshme, inflamatore ose e rrezikshme. Ajo bazohet në idenë/mendimin se diçka aq e spikatur sa një elefant mund të duket se anashkalohet në bashkëveprimet e kodifikuara shoqërore dhe se sociologjia/psikologjia e represionit gjithashtu vepron në shkallën makro. Gjuhë të ndryshme në të gjithë botën kanë fjalë që përshkruajnë koncepte të ngjashme. (Burimet: Cambridge University Press. (2009). Cambridge academic content dictionary, p. 298. dhe “Elephant in the room Idiom Definition – Grammarist”. grammarist.com. Qasur më 28.01.2021.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	6
HYRJE	7
1. Trashëgimia kulturore në Kosovë, institucionet dhe mekanizmat mbrojtës	9
1.1.Mbrojtja e trashëgimisë kulturore para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (periudha 1974 – 2008)	9
1.2 Korniza ligjore para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	12
1.3 Korniza institucionale	12
1.4 Gjendja e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe zbatimi i ligjit	13
2. Trashëgimia kulturore e komunitetit serb në Kosovë	14
2.1 Vlerat dhe tiparet e trashëgimisë kulturore	14
2.2 Baza kushtetuese dhe ligjore pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	15
2.3 Monumentet mesjetare të Kosovës në UNESCO dhe Lista e Trashëgimisë Botërore	17
3. Shembujt e trajtimit të trashëgimisë kulturore të komunitetit serb në Kosovë	22
3.1 Komisioni për Rindërtim dhe Zbatim (2004)	20
3.2 Punët restauruese dhe iniciativat për turizëm rural në fshatin Hoçë e Madhe, Rahovec (2004)	22
3.3 Aktet e vandalizmit ndaj Kishës Ortodokse Serbe dhe gjendja e lirive fetare në Kosovë (2007)	22
3.4 Ngjyrosja e fasadës dhe ndërtimi i mureve rrethuese të Patrikanës së Pejës (2008 – 2010)	26
3.5 Mbështetja e Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (2009-15)	27
3.6 Vizitat turistike në Manastirin e Deçanit, të Graçanicës dhe Patrikanën e Pejës (2011)	28
3.7 Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore në Partesh dhe investimet e bazuar në plan 2012-15	28
3.8 Restaurimi i Kishës së Shën Nikollës në Bogoshevc, Prizren (2012)	30
3.9 Këshilli i Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit dhe fshatin Hoçë e Madhe në Rahovec (2013)	30
3.10 Programi i BE-së “Kosova e bukur” (2011-16)	31

3.11 Promovimi i paqes dhe dialogut ndërfetar në Kosovë (2013-16).....	32
3.12 Programet e UNDP për mbrojtje dhe rehabilitim të trashëgimisë kulturore (2016- 20)	33
3.13 Ngritja e kapaciteteve të guidave turistike me etni të ndryshme (2019).....	34
3.14 Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit (2020).....	35
3.15 Promovimi i turizmit të Kosovës në relacion me trashëgiminë ortodokse (2020)	36
3.16 Rruga e kontestuar e Manastirit të Deçanit (2020).....	36
3.17 Manastiri i Deçanit, në listën preliminare të 12 aseteve të trashëgimisë Evropiane më të rrezikuara për vitin 2021 (2020).....	38
3.18 Rekapitullim.....	39
4. Eksterritorialiteti në kontekst të dialogut të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.....	40
4.1 Prapavija e procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe eksterritorialiteti.....	40
4.2 Çka është eksterritorialiteti?	42
4.3 Aplikimi i eksterritorialitetit në kontekst të trashëgimisë kulturore në botë	43
Pronat eksterritoriale të Selisë së Shenjtë (Shteti i Vatikanit) në Romë (Itali).....	44
Kalaja St. Angelo në Maltë	44
Varri i Shah Sulejmanit në Siri.....	45
Longwood House në Shën Helenë.....	45
Mali Atos në Greqi.....	46
4.4 Cilat janë kompetencat e Kishës Ortodokse Serbe sot në Kosovë dhe a mund të zbatohet eksterritorialiteti si kërkesë shtesë për këtë institucion?	47
4.5 Rekapitullim.....	49
5. Konkluzione dhe rekomandime	50

HYRJA

"Kultura është në front të konfliktit – ajo do të duhej të ishte në front të ndërtimit të paqes" – Irina Bokova, ish Drejtore e Përgjithshme e UNESCO-s²

"Trashëgimia kulturore paraqet një grupim të burimeve të trashëguara nga e kaluara, të identifikuar nga njerëzit si refleksion dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave gjithnjë e në zhvillim, pavarësisht nga pronësia. Ajo përfshin të gjitha aspektet e mjedisit që rezultojnë si ndërveprim ndërmjet njerëzve dhe vendeve gjatë kohës" – Konventa Faro, 2005³

Trashëgimia kulturore bën pjesë në të drejtat për kulturë, të përcaktuar në nenin 27 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.⁴ Në të drejtat kulturore përfshihen të drejtat e njerëzve dhe komuniteteve për të njohur, kuptuar, vizituar, përjetuar, mirëmbajtur dhe shfrytëzuar trashëgiminë kulturore dhe shprehjet kulturore, si dhe të drejtën për të luajtur një rol të barabartë në procesin e identifikimit, ruajtjes dhe transmetimit të vlerave të trashëgimisë kulturore në gjeneratat e ardhshme. Të drejtat tjera kulturore përfshijnë të drejtën për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për edukim.

Trashëgimia kulturore e Kosovës është shprehje dhe krijimtari e realiteteve jetësore të zhvilluara në harkun kohor mbi tetë mijë vjet, që nga parahistoria në vijim e deri më sot. Kjo pasuri e trashëguar me vlera unike artistike, estetike, historike dhe karakteristika tradicionale, ilustron diversitetin e pasur të trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, si dhe me peizazhin e pasur kulturor.⁵ Gjurmët arkeologjike që datojnë nga periudha e parahistorisë e deri në antikitet paraqesin dëshmi të qendrave urbane me kulturë të rafinuar. Monumete të jashtëzakonshme arkitektonike të ndërtuara gjatë Mesjetës dhe periudhës Osmane kanë ruajtur integritetin deri në ditët e sotme: kisha dhe manastire të shekullit të 14-të me një

arritje estetike unike dhe xhamitë me përsosmëri të madhe stilistike, por edhe ndërtesa jo fetare sikurse fortifikatat, qendrat e vjetra urbane, arkitektura e banimit, urat, nxjerrin në pah krijimtarinë e dendur artistike që është karakteristike për këtë rajon, dhe formësojnë trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës.⁶

Mbrojtja e trashëgimisë së pasur kulturore nënkupton njëkohësisht edhe ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit të këtyre vlerave, duke ofruar kushte të përshtatshme që këto vlera të jenë të qasshme, në këtë mënyrë duke e shndërruar atë në pjesë të jetesës për komunitetin. Mbrojtja e trashëgimisë së pasur kulturore të Kosovës paraqet një prej shtyllave kryesore të procesit të themelimit të institucioneve publike duke qenë e drejtë e cila garantohet edhe në Kushtetutën e Kosovës. Neni 9 i Kushtetutës është përcaktuar që "Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare".

2 Bokova Irina, Address to UN Security Council, 2015, <https://whc.unesco.org/en/news/1269>, qasur 30.01.2021.

3 Këshilli i Europës, Convention on the Value of Cultural Heritage for Society (Konventa mbi Vlerat e Trashëgimisë Kulturore për Komunitetin), <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae695>, qasur 15.01.2021.

4 UNESCO, The right to Culture (E Drejta për Kulturë), http://www.unesco.org/culture/culture-sector-knowledge-management-tools/10_Info%20Sheet_Right%20to%20Culture.pdf, qasur Qershor 15.01.2021.

5 Jerliu Florina, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, (Pristinë: MKRS, 2017), f. 22.

6 UNESCO, Cultural Heritage in South East Europe: Kosovo, Mission Report 26-30 April 2004, Cultural Heritage in South-East Europe Series No.2, http://portal.unesco.org/en/files/20053/10827207031Pages_1-14_KOSOVO_report_distilled.pdf/Pages+1-14+KOSOVO_report_distilled.pdf, qasur 13.1.2021.

QËLLIMI KRYESOR I KËTIJ HULUMTIMI

është analiza e mekanizmave mbrojtës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe në veçanti atë të trashëgimisë kulturore të komunitetit serb në Kosovë.

Duke u nisur nga titulli relativisht provokues “Elefanti në dhomë...”, hulumtimi synon të pasqyrojë gjendjen se si trashëgimia kulturore e Kosovës, në veçanti ajo e komunitetit serb, pas luftës së vitit 1999 dhe trazirave të Marsit 2004 më shumë ka qenë pjesë e diskursit dhe fjalorit të politikaneve e delegacioneve të ndryshme në procese politike dhe shumë më pak në narracionin e profesionistëve të fushës. Për më tepër, qytetarët dhe komunitetet kanë qenë gati se të marginalizuar në trajtimin e kësaj teme. Për këtë temë, përfaqësuesit politik dhe të bashkësive fetare, më shumë kanë krijuar barriera dhe e kanë përdorur atë si mjet për krijim të fërkimeve politike dhe narracioneve nacionaliste se sa të krijojnë një fushë për bashkëpunim dhe krijim të respektit e paqes së ndërsjellë.

Është e pakontestueshme që trashëgimia kulturore ndërlihet edhe me aspektin politik pasi që ajo reflekton të kaluarën dhe identitetet e ndryshme të shtresuara gjatë historisë. Ajo evokon kujtime të mira, krenarie por edhe ndonjëherë kujtime negative tek njerëzit. Mu për këtë arsye, trashëgimia kulturore gjithmonë bart edhe emocionin dhe përkushtimin e njerëzve për mbrojtje por edhe promovim si element krenarie të cilën synojnë ta transmetojnë gjeneratë pas gjenerate. Në këtë kontekst, hulumtimi NUK KA PËR QËLLIM të elaborojë argumentet historike dhe juridike qindrvajçare të dy palëve dhe burimet potenciale të konflikteve në këtë aspekt, por fokusohet në historinë bashkëkohore të periudhës së shtet-formimit dhe shtet-ndërtimit të Kosovës, që nga lufta e vitit 1999 e deri më sot.

Ky hulumtim përmes elaborimit të gjendjes ekzistuese identifikon të gjitha mekanizmat ligjor dhe institucional në shërbim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore Kosovës ku trajton në mënyrë të veçantë të drejtat e komunitetit serb, gjegjësisht ato të Kishës Ortodokse Serbe të Kosovës si institucion fetar dhe pronar i një numri të madh të aseteve. Hulumtimi synon të jep një këndvështrim të profesionistëve të trashëgimisë kulturore ku përmes pasqyrit të gjendjes ekzistuese dhe parimeve universale të trashëgimisë jep përgjigje në sfidat që paraqiten në këtë fushë. Dokumenti paraqet projekte, investime e shembuj pozitiv dhe negativ të trajtimit të trashëgimisë kulturore që i gëzon komunitetit serb në Kosovë.

Në mënyrë të paevitueshme, dokumenti trajton edhe temën e eksterritorialitet të Kishës Ortodokse Serbe, temë e cila ka filluar të përmendet “jo-zyrtarisht” në kuadër të procesit të dialogut të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, si një nga kërkesat e cila potencialisht mund të vie nga Serbia në këtë proces.

Pjesa e fundit përmbledh konkluzionet dhe rekomandimet për tejkalim të sfidave të identifikuara në këtë hulumtim.

1. TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOSOVË, INSTITUCIONET DHE MEKANIZMAT MBROJTËS

1.1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (periudha 1974 – 2008)

Në përgjithësi, fusha e trashëgimisë kulturore në Kosovë është një fushë e brishtë dhe e cenueshme si pasojë e zhvillimeve historike që kanë ndikuar në këtë gjendje. Në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e qartë e situatës aktuale, duhet të rikthehemi në retrospektivë për të theksuar disa faza të rëndësishme që kanë ndikuar në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Gjatë pjesës së dytë të shek. XX, në kohën kur Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë, trashëgimia kulturore është ri-përcaktuar dhe menaxhuar në bazë të standardeve të përcaktuara nga regjimet politike.⁷ Ndërmjet viteve 1947 dhe 1990 në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje kanë qenë gjithsej 425 monumente. Nga këto 96 kanë qenë lokalitete arkeologjike, 16 varreza, 116 ndërtesa profane dhe 174 ndërtesa fetare, 139 nga të cilët kanë qenë kisha dhe manastire Ortodokse.⁸ Në këtë listë kanë qenë vetëm 32 monumente fetare islame⁹, nga rreth 600 xhami që ekzistonin në Kosovë, edhe pse gjysma e tyre datonin nga periudha Osmane.¹⁰ Përderisa monumentet e listuar kanë gëzuar mbrojtje institucionale, duke u hulumtuar,

ruajtur dhe promovuar, kategoritë që nuk janë listuar, janë lënë në mëshirë të kohës dhe të shfrytëzuesve të tyre.

Lufta e viteve 1998-1999 ka përkeqësuar këtë gjendje, ku krahas katastrofës humanitare, konfliktit të armatosur dhe spastrimit etnik, ndërtesat që karakterizojnë identitetin kulturor dhe fetar, kanë qenë shënjestër e akteve të dëmtimit dhe shkatërrimit. Krahas shkatërtimeve në zonat rurale dhe urbane, janë shkatërruar rreth 200 xhami, tri qendra historike (Gjakovë*, Pejë* dhe Vushtrri), më se 400 kulla tradicionale si dhe Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.¹¹ Gjykimi i krimeve nga Tribunali Ndërkombëtar është fokusuar kryesisht në vrasjet dhe dëbimin masiv, duke e neglizhuar dëmtimin sistematik të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Por, në bazë të evidentimit të kryer nga dy ekspert akademik, dëmtimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare është adresuar në tri procese gjyqësore¹². Në bazë të dëshmive të paraqitura, gjykatësit kanë arritur në konstatim që shënjestrimi i këtyre monumenteve fetare është bazuar në qëllime diskriminuese, me qëllim të vetëm: eliminimi i pjesëtarëve të komuniteteve etnike dhe fetare, monumentet e të cilëve kanë qenë duke u shkatërruar. Ky shkatërrim i vlerave të trashëgimisë kulturore është vlerësuar si krim kundër njerëzimit.¹³

7 Hoxha Gjejlane, "Legal Protection of Cultural Heritage in Kosovo, Past, Presence and Future", prezantuar në Balkanlarda Osmanli Vakıfları ve Eserleri Uluslararası Sempozyumu, (2012), f. 220, <http://acikerisim.fsm.edu.tr:8080/xmlui/handle/11352/1783#sthash.1ZMNoMuQ.dpbs>, qasur 18.01.2021.

8 Ibid, f. 217-237.

9 Ibid, f. 217-237.

10 Herscher Andrew & Andras Riedlmayer, Monument and Crime: The destruction of Historic Architecture in Kosovo, in Grey Room, The MIT Press, pp.108-122, <http://www.jstor.org/stable/1262553>, qasur 23.11.2010.

11 Ibid.

Carshitë e vjetra të Pejës dhe Gjakovës kanë qenë të përfshira në listën e përmendoreve të vitit 1954, si tërësi urbanistike.

12 International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (ICTY), Targeting History and Memory Kosovo, <http://heritage.sensecentar.org/> qasur 17.01.2021.

13 International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (ICTY), Targeting History and Memory Kosovo, <http://heritage.sensecentar.org/> qasur 17.01.2021.

Gjatë viteve 1998 – 1999 artefakte nga ekspozita arkeologjike dhe etnologjike e Muzeut të Kosovës dhe të muzeve regjionale në Prizren dhe Mitrovicë, janë huazuar për tu dërguar në një ekspozitë në Beograd, si dhe dokumentacioni arkivor i Institutit për Mbrojtje të Monumenteve të Kosovës, është dërguar në Serbi.¹⁴ Nga fondi i artefakteve arkeologjike janë marrë rreth 643 artefakte, si dhe rreth 2480 ekspozate etnologjike¹⁵. Nga këto, deri tani vetëm një artefakt “Hyjnesha në Fron” në vitin 2002 është kthyer në Kosovë, me ndërmjetësimin e ish-kryeadministratorit të Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNMIK), Michael Steiner. Pjesa tjetër e fondit arkeologjik dhe etnologjik vazhdon të mbetet në Beograd.

Fatkeqësisht, ndërtesat fetare kanë vazhduar të jenë shënjestër e dëmtimeve dhe shkatërrimeve të qëllimshme, edhe pas vendosjes së trupave paqeruajtëse të KFOR-it dhe institucioneve të përkohshme të UNMIK-ut në territor të Kosovës. Gjatë gjysmës së dytë të qershorit 1999, kishat dhe manastiret kryesisht të vendosura në zona rurale, janë dëmtuar dhe shkatërruar. Rreth 70 ndërtesa dhe një numër i memorialeve janë dëmtuar ose shkatërruar, ku shumica datonin nga shek. XX, kurse një numër i caktuar ishin edhe monumente të listuara nga periudha Mesjetare.¹⁶

Menjëherë pas ndërhyrjes së trupave të NATO-s, Kosova është shpallur një protektorat i Kombeve të Bashkuara, duke u vënë nën administrimin ndërkombëtar dhe të cilët ofronin prezencë të forcave të armatosura të sigurisë. Prezenca e administratës civile ndërkombëtare kishte për qëllim primar asistimin e zhvillimit të institucioneve demokratike. Çështja e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nuk është adresuar nga UNMIK-u, pasi që fokusi primar ishte në prioritetet e interesit vital, sikurse siguria, ekonomika dhe amnistrimi civil.¹⁷

Në rrethana jo stabile politike, trazirat gjatë Marsit 2004, ku janë dëmtuar rëndë 34 ndërtesa ortodokse, kanë dëshmuar që mekanizmat dhe strategjitë e atëhershme të cilët krye-

sisht kanë qenë të fokusuar në sigurim të jetës së njerëzve, nuk kanë qenë adekuate për sigurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.¹⁸

Pas ngjarjeve tragjike të kësaj periudhe jo-stabile, organizatat ndërkombëtare sikurse UNESCO, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, etj., kanë kushtuar një vëmendje të theksuar, të cilët janë fokusuar në ofrimin e asistencës teknike, profesionale dhe financiare për krijimin e bazës për mbrojtje ligjore dhe institucionale, me qëllim të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore si faktor pajtimi dhe bashkërendimi ndërmjet komuniteteve.

Shteti i Serbisë duke u referuar në nënshkrimin e dokumentit së bashku me përfaqësuesin special të sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara, ku është konfirmuar pranimi i aplikimit të provizioneve të Konventës së Hagës në vitin 2001, ka ushtruar presion të vazhdueshëm në organizatat ndërkombëtare (UNESCO), duke kërkuar marrjen e masave për mbrojtjen dhe sigurimin e monumenteve të dëmtuara, me theks të veçantë të trashëgimisë kulturore mesjetare në Kosovë¹⁹. Krahas presionit diplomatik, duhet të theksohet Serbia nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rindërtim të monumenteve të shkatërruara gjatë luftës së viteve 1998-1999, ku janë përfshirë edhe monumentet fetare islame dhe ato të banimit, për të cilët edhe është shpallur fajtor nga Tribunali ndërkombëtar i krimeve për ish-Jugosllavinë.²⁰ Si rezultat i presionit të vazhdueshëm nga ekspertët serb, delegacione të ekspertëve të angazhuar nga UNESCO kanë kryer vizita në terren (gjatë viteve 2003, 2004) me qëllim të vlerësimit të gjendjes së konservimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe vlerësimit teknik të propozimeve fillestare për rehabilitim dhe ruajtje.²¹ Në bazë të raporteve të publikuara vërehet që një fokus i veçantë iu është kushtuar monumenteve fetare ortodokse.

Ajo çka vërehet nga raportet e publikuara, sidomos pas trazirave të Marsit 2004, është fakti që përderisa dëmtimet e shkaktuara në ndërtesat e trashëgimisë kulturore që

14 Hoxha Gjejlane, Legal Protection of Cultural Heritage in Kosovo, Past, Presence and Future, prezantuar në Balkanlarda Osmanli Vakıfları ve Eserleri Uluslararası Sempozyumu, (2012), f. 222, <http://acikerisim.fsm.edu.tr:8080/xmlui/handle/11352/1783#sthash.1ZMNoMuQ.dpbs>, qasur 18.01.2021.

15 Kosovalive, “Një trashëgimi kulturore si peng lufte”, 2015, <https://kosovalive.org/2015/11/24/nje-trashegimi-kulturore-si-nje-peng-lufte/>, qasur 01.02.2021.

16 Herscher Andrew & Andras Riedlmayer, Monument and Crime: The destruction of Historic Architecture in Kosovo, in Grey Room, The MIT Press, pp.108-122, <http://www.jstor.org/stable/1262553>, qasur 23.11.2010.

17 UNESCO, Cultural Heritage in South East Europe: Kosovo, Mission Report 26-30 April 2004, Cultural Heritage in South-East Europe Series No.2, http://portal.unesco.org/en/files/20053/10827207031Pages_1-14_KOSOVO_report_distilled.pdf/Pages+1-14+KOSOVO_report_distilled.pdf, qasur 13.1.2021.

18 UNESCO, Cultural Heritage in South East Europe: Kosovo, Mission Report 26-30 April 2004, Cultural Heritage in South-East Europe Series No.2, http://portal.unesco.org/en/files/20053/10827207031Pages_1-14_KOSOVO_report_distilled.pdf/Pages+1-14+KOSOVO_report_distilled.pdf, qasur 13.1.2021.

19 Ibid.

20 International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (ICTY), Targeting History and Memory Kosovo, <http://heritage.sensecentar.org/> qasur 17.01.2021.

21 UNESCO, Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo, 2003, <http://erc.unesco.org/seeconference>, qasur 18.01.2021.

përfaqësojnë monumente arkitekturale islame, qendrat historike të qyteteve, dhe ndërtimet popullore të banimit paraqiten në mënyrë jo të detajuar, kështu duke u përgjithësuar dëmtimet e shkaktuara gjatë luftës së viteve 1998-1999. Dëmtimet e shkaktuara në qendrat historike të tri qyteteve, fare nuk janë vizituar dhe trajtuar. Monumentet arkitekturale islame janë vizituar vetëm në qendrat kryesore urbane, duke anashkaluar xhamitë e shkatërruara në qytetet më të vogla dhe zonat rurale. Sa i përket arkitekturës së banimit, respektivisht kullat e gurit, ato janë paraqitur vetëm të përgjithësuara nëpërmjet ilustrimit të shembullit të Kullave të Deçanit.

Në anën tjetër, gjysma e monumenteve arkitekturale bizantine/ortodokse të dëmtuara gjatë viteve 1999 dhe 2004, janë vizituar dhe vlerësuar gjendja e tyre, ku është ritheksuar edhe informata nëse gjatë konfliktit të armatosur në vitin 1999 ndërtesa ka pësuar dëme, përfshi edhe atë për trazirat e Marsit 2004. Nëse duhet të elaborohet si ilustrim, përderisa për dëmtimet e shkaktuara në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë, përshkruhet se xhamia ka qenë pjesë e një kompleksi i cili është shkatërruar në vitin 1999²², të përshkrimi i gjendjes për Patrikanën e Pejës, përshkruhet se si kompleksi ka mbijetuar periudhën e vështirë të konfliktit të armatosur të vitit 1999, pa ndonjë dëmtim serioz.²³ Duhet të theksohet se të dy ndërtesat e lartpërmendura, kanë qenë në listën e monumenteve të mbrojtura me ligj.

1.2. Korniza ligjore para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Në vitin 2001 janë vënë themelet e bazës kushtetuese duke u aprovuar Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9). Ky dokument ka paraqitur bazën për themelimin e strukturave demokratike dhe orientuese në procesin e statusit përfundimtar të Kosovës. Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, trajtohet në kuadër të kapitullit për të drejtat e komuniteteve, ku institucionet kërkohet që të nxisin ruajtjen e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve të Kosovës pa diskriminim.²⁴

Baza ligjore në Kosovë ofron kornizën për mbrojtjen, ruajtjen, qasjen, komunikimin dhe burimet që vlerat e trashëgimisë kulturore të përjetohen nga të gjitha komunitetet dhe të transmetohen për gjeneratat e ardhshme. Fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore rregullohet përmes Ligjit (Nr.02/L-088) për Trashëgiminë Kulturore²⁵ i hartuar me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtar, dhe i miratuar në vitin 2006. Përcaktimi i nocioneve bazë dhe mekanizmave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është bërë duke u mbështetur në parimet dhe principet ndërkombëtare. Sipas këtij ligji, trashëgimia kulturore përfshin trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme, shpirtërore dhe peizazhet kulturore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit e punës. (Neni 1.3). Në këtë ligj, trashëgimia kulturore që ndërlidhet ose derivon nga konfesionet fetare do të jetë e qeverisur nga legjislacioni i cili rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë. (Neni 1.3). Në kuadër të këtij ligji janë hartuar tetë rregullore që ndihmojnë në qartësimin e detyrave dhe përgjegjësisve dhe sigurojnë një zbatim të efektshëm të tij.²⁶

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ka derivuar si rezultat i Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës²⁷ (i njohur si Pakoja e Ahtisarit). Aneksi V i këtij propozimi përfshin masat për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë. E hartuar në përputhje me frymën e Pakos së Ahtisaarit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

Pakoja e Ahtisaarit është zbatuar në nivel të mekanizmave ligjorë, nëpërmjet hartimit dhe adoptimit të një sërë ligjeve të veçanta për fushat specifike, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe atë fetare.

Ligji (Nr.02/L-088) për Trashëgiminë Kulturore nuk është amandamentuar edhe pas shpalljes së Pavarësisë, por është plotësuar përmes akteve nënligjore, dhe ligjeve të veçanta.

²² Ibid, faqet 80 – 82.

²³ Ibid, faqet 15-16.

²⁴ <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2019/01/korniza1494293911.pdf>, qasur 11.03.2021.

²⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>, qasur 18.01.2021.

²⁶ Salë Shoshi, Hulumtim Parlamentar Zbatimi i ligjit nr.02/L-088 për trashëgimi kulturore, (Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019).

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Final%20Settlement%20Proposal%20AL.pdf>, qasur 20.01.2021.

Mbrojtja ligjore e aseteve të trashëgimisë kulturore zbatohet përmes inventarizimit, dokumentimit dhe propozimit për mbrojtje të përkohshme dhe përhershme. Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme, për herë të parë është zyrtarizuar në vitin 2011²⁸ dhe përditësohet në baza vjetore. Në vitin 2016 është zyrtarizuar Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme, e cila përfshin gjithsej 23 asete.

Në vitin 2017, është hartuar Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027²⁹, e cila synon zhvillimin e mekanizmave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në përputhje me kornizën ligjore dhe parimet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e kulturor. Me këtë Strategji, trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, e cila synon promovimin e vlerave të përbashkëta shoqërore dhe kulturore, përmes avancimit të kornizës ligjore, qasjes së integruar, përfshirjes së trashëgimisë në plane zhvillimore, dhe promovim, edukim dhe pjesëmarrje aktive të komunitetit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme për vitet 2020-2021 është shpallur në tetor 2020, dhe përmban 1612³⁰ asete të kategorizuar sipas kategorive ligjore, të lartpërmendura.

Ligjet tjera relevante në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore përfshijnë Ligjin (Nr. 04 – L/174) për Planifikim Hapësinor³¹, Ligjin (Nr.03/L-040) mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin (Nr. 03-L-047) për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligjin (Nr.04/L-110) për Ndërtim dhe Ligji (Nr.03/L-039) për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji (Nr. 04/L-066) për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji (Nr. 04/L-62) për Fshatin Hoçë e Madhe, të cilët do të trajtohen më tej në hulumtim.

1.3. Korniza Institucionale

Fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë menaxhohet nga institucionet e nivelit qendror, ku përgjegjësinë kryesore e mban Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore³². Ky departament ka nën vartësi tri institucione qendrore, dhe shtatë qendra rajonale, nëpërmjet të cilëve zhvillohen politikat programore për zhvillim të strategjive për inventarizim, ruajtjen dhe mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore, hartimin e planeve të ndërhyrjeve për ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është agjenci e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, në përputhje me Ligjin (02/L-088) për Trashëgiminë Kulturore³³, dhe ka mandat kryesor aprovimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme, identifikimin e prioritetëve financiarë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për avancimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Bordi i KKTK-së përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat tri (3) vjeçar, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë. Dy nga shtatë anëtarët janë përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë.³⁴ Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është përzgjedhur për herë të fundit në vitin 2015, me mandat 3 vjeçar. Gjatë këtij mandati është shpallur Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme, ku janë listuar 23 asete.³⁵ Aktualisht ky Këshill nuk është funksional, dhe pritet të zgjedhet dhe funksionalizohet. Si rrjedhojë, një proces shumë i rëndësishëm i shpalljes së listës së trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme mbetet pezull.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (Emërtimi aktual: Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, përgjegjësinë kryesore e ka në përcaktim të zonave të mbrojtjes, zbatim të legjisllacionit që ndërlidhet me Zonat e Veçanta të Mbrojtura, dhe integrimin e këtyre zonave në dokumentet e planifikimit hapësinor.

28 Krasniqi Memli, "Positive changes in culture, sport, cultural heritage and youth in 2011" in Kosovo's Culture, Youth and Sport Newsletter, No.1, January-February 2012, 2.

29 Jerliu Florina, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, (Prishtinë: MKRS, 2017), http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf, qasur Qershor 2020.

30 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Regjistri_i_Trash%C3%ABgimis%C3%AB_Kulturore_-_Shqip.pdf, qasur 19.01.2021.

31 Kuvendi i Kosovës, Ligji (Nr. 04 – L/174) për Planifikim Hapësinor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>, qasur 17.01.2021.

32 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,10>, qasur 18.01.2021

33 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>, qasur 18.01.2021.

34 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, <https://kktk.rks-gov.net/Home/Organization>, qasur 11.03.2021.

35 Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përhershme, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Mbrojtja_e_perhershme.pdf, qasur 19.01.2021.

Një çështje tjetër që ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë ndërhyrjet e gabuara restauruese dhe konservuese. Gjatë viteve të kaluara dhe sidomos gjatë vitit 2019 është raportuar për

Poshtu sipas raportit “Gabim pas gabimi – Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore” të organizatës EC Ma Ndryshe, fondet publike në dispozicion të trashëgimisë kulturore në përgjithësi, dhe rrjedhimisht ato për intervenime emergjente në veçanti janë nën minimumin e nevojave të këtij sektori, ndërsa praktika e intervenimeve emergjente bëhen pa plane dhe standarde profesionale, përmes kompanive të ndërtimit, të cilat nuk i kanë as licencat e nevojshme për të kryer intervenime në trashëgimi kulturore.⁴²

42 EC Ma Ndryshe, "GABIM PAS GABIMI Analizë mbi gabimet e panumëta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore; Seria e analizave Çka shkoi ters?", (EC Ma Ndryshe: Prishtina, 2013), f. 8

2. TRASHËGIMIA KULTURORE E KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË

2.1. Vlerat dhe tiparet e trashëgimisë kulturore

Monumentet arkitekturale, respektivisht kishat dhe manastiret të cilët datojnë nga shek. XIV, njihen botërisht si shembuj të jashtëzakonshëm të arkitekturës fetare mesjetare në Evropë. "Katër lokalitete pasqyrojnë arritjet më të larta të kulturës

murale, i cili u zhvillua në Ballkan gjatë shekujve XIII – XVII. Manastiri i Deçanit u ndërtua në mes të shek. XIV për mbretin serb Stefan Dečanski dhe është gjithashtu mauzoleu i tij. Patriarkana e Manastirit të Pejës paraqet një grup prej katër kishave me kupolë, që shfaqin një seri pikturash murale. Afresket e Kishës së Apostujve të Shenjtë, në Manastirin e Graçanicës, të shek. XIII janë pikturuar me një stil unik monumental. Afresket



Foto 1: Kisha e Shën Premtes në Prizren, pjesë e listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s (Burimi: Photo Balkan)

vishës (Prizren), paraqesin një stil të ri të ashtuquajtur Rilindje Palaiologiane, duke kombinuar ndikimet e traditës Ortodokse Bizantine dhe Romane Perëndimore. Ky stil ka luajtur rol vendimtar në artin vijues në Ballkan⁴³.

Këto monumente fetare, së bashku me arkitekturën e banimit dhe trashëgiminë e pasur shpirtërore e jo-materiale të komunitetit serb, e plotësojnë mozaikun e pasur të diversitetit kulturor të Kosovës.

2.2. Baza kushtetuese dhe ligjore pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare është e drejtë e cila sigurohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës⁴⁴, e cila njëkohësisht edhe ofron mbrojtjen e autonomisë fetare dhe të monumenteve fetare brenda territorit të saj, duke e theksuar edhe faktin që shteti është laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare.

Përkundër faktit që në bazën ligjore të Kosovës, trashëgimia kulturore kategorizohet në përputhje me principet dhe parimet e konventave ndërkombëtare, dhe nuk paraqitet ndarja e kategorive të trashëgimisë sipas përkatësisë fetare apo nacionale, trashëgimia kulturore dhe fetare e komunitetit serb në Kosovë, gëzon mbrojtje të veçantë, përmes mekanizmave ligjor shtesë. Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës⁴⁵ (i njohur si Pakoja e Ahtisarit), është parë si kompromis i pranuar nga Kosova (në këmbim të pranimit të pranimit të pavarësisë), përmes së cilës serbët dhe Kisha Ortodokse Serbe kanë përfituar mekanizma shtesë. Ndonëse miratimi i propozimit si traktat paqeje ndërmjet dy vendeve dështoi⁴⁶, dispozitat e paraqitura në propozimin gjithëpërfshirës u morën për bazë dhe u miratuan përmes ligjeve të veçanta, gjatë procesit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, dhe përfundimit të Mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës, në shtator të vitit 2012.⁴⁷ Përderisa Kushtetuta e

Republikës së Kosovës është gjithëpërfshirëse në aspektin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe fryma e propozimit gjithëpërfshirës është adoptuar në parim, përmbajtja e Pakos së Ahtisarit për tema specifike, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të komunitetit serb, është aprovuar, përmes adoptimit të një sërë ligjeve shtesë.

Aneksi V i këtij propozimi përfshin masat për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore, në veçanti të manastireve dhe kishave ortodokse dhe të monumenteve me vlerë të veçantë për komunitetin serb në Kosovë. Gjithashtu trajton aspektin e mbështetjes ekonomike, sigurinë e zonave fetare dhe kulturore, duke propozuar edhe themelimin e zonave të mbrojtjes rreth tyre, themelimin e Këshillit Zbatues Monitorues, si dhe kthimin e artefakteve arkeologjike dhe etnologjike të marra Muzeu i Kosovës gjatë viteve 1998-1999. Ky aneks është inkorporuar në kornizën ligjore të Kosovës, nëpërmjet hartimit dhe aprovimit të Ligjit (Nr.03/L-039) për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.⁴⁸ Përmes këtij ligji themelohen zona të veçanta për rreth 44 monumente të rëndësishme fetare ortodokse të cilët do të gëzojnë mbrojtje të veçantë, e cila rregullon emrin, organizimin e brendshëm dhe pronat e Kishës Ortodokse Serbe, në territorin e Kosovës. Identifikimi dhe përcaktimi i sipërfaqeve të Zonave të Veçanta të Mbrojtura është bërë nga një grup ekspertësh ndërkombëtar nga Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe UNESCO.⁴⁹

Në këtë ligj janë përfshirë 21 Manastire Ortodokse, 17 Kisha Mesjetare ortodokse, Patriarkana e Pejës, Kështjella, Monument memorial, Kompleks Memorial, Urë dhe dy qendra historike: Fshati Hoçë e Madhe dhe Qendra Historike e Prizrenit. Dispozitat e veçanta për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit rregullohen përmes ligjeve të veçanta: Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe.⁵⁰ Këto dy ligje rregullojnë fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në relacion me ligjin për planifikim hapësinor dhe për trashëgiminë kulturore,

43 UNESCO, Medieval Monuments in Kosovo, <https://whc.unesco.org/en/list/724/>, qasur 31.01.2021.

44 Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenet 9 dhe 39), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, qasur 20.01.2021

45 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Final%20Settlement%20Proposal%20AL.pdf>, qasur 20.01.2021.

46 Nikander Päivi dhe Valerie Zirl, Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë – mjet ndërtimi për paqe, OSCE, 2016, <https://www.osce.org/sq/magazine/277371>, qasur 20.01.2021

47 Kuvendi i Kosovës, Rezolutë për Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3707>, qasur 20.01.2021.

48 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3303>, qasur 20.01.2021.

49 Arraiza Jose Maria, "A matter of balance – cultural heritage, property rights and inter-ethnic relations in Kosovo" në Seminar on Property and Investment in Jus Post Bellum, (Hagë, 2014), https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2504990, qasur 21.01.2021.

50 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2836>, dhe Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2835>.




Foto 2: Shembulli i zonës së mbrojtjes e përcaktuar me hartë të veçantë në aneks të Pakos së Ahtisarit kur nuk aplikohet standardi 50 apo 100 metra nga lokaliteti i trashëgimisë. Rasti i Manastirit të Gorioqit, Istog (Burimi: Pakoja e Ahtisarit)

dhe njëkohësisht duke shërbyer edhe si mekanizëm ligjor për rregullim të përgjegjësi dhe detyrimeve ndërmjet institucioneve të nivelit qendror (MMPH, MKRS, IKMM), regional (QRTK Prizren – në ligj IMM Pz) dhe lokal (Komuna e Prizrenit dhe e Rahovecit), në fushën e mbrojtjes dhe administrimit të këtyre zonave të veçanta të mbrojtura.

Në këtë rast, ligji për zonat e veçanta të mbrojtura e plotëson fushëveprimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës, fillimisht duke shtuar një masë mbrojtëse shtesë (të zonës së veçantë të mbrojtur), dhe duke përcaktuar qartë kufijtë e zonave mbrojtëse, dhe aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara në këto zona.

Kufijtë e zonave mbrojtëse përcaktohen në hapësira të përcaktuara në harta të veçanta apo edhe në radius 50, gjeg-

jësisht 100 metra nga lokaliteti.⁵¹ Në këto zona mbrojtëse ndalohen zhvillimet e aktiviteteve të pafavorshme që do të degradonin vlerat e trashëgimisë kulturore, sikurse ndërtimet apo zhvillimet industriale, eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike dhe rrugëve tranzite në zontat rurale.⁵² Aktivitete të kufizuara në këto zona përfshijnë ndërtimet komerciale sikurse ndërtesat më të larta se monumenti kulturor, ndërtime me shkallë të gjerë në zona rurale dhe urbanizimi i tokës bujqësore.⁵³

Në vitin 2012, në kuadër të procesit të përmbylljes së Mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, janë bërë amandamentime në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në nenin 81 (Legjislacioni me interes vital) janë përfshirë edhe Ligjet për Mbrojtjen e Trashëgimisë

⁵¹ Neni 7.1, 7.4 dhe 7.5 i Ligjit për Ligji Nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura

⁵² Neni 5 dhe 6 i Ligjit për Ligji Nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura.

⁵³ Ibid.

Kulturore. Sipas këtij neni: "...për miratim, ndryshim ose shfuqizim të ligjeve me interes vital, kërkohet shumica e dyfishit të votave, pra shumica e votave të deputetëve të pranishëm, dhe të cilët mbajnë vende të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë".⁵⁴ Në këtë mënyrë edhe Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, fillimisht i hartuar si ligj i planifikimit hapësinor, në mbështetje të ligjit për trashëgimi kulturore, tani konsiderohet ligj me interes vital për Republikën e Kosovës.

Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme për vitet 2020-21 përmban asete të kategorizuar në trashëgiminë arkeologjike, arkitektonike, të luajtshme, shpirtërore dhe peizazhet kulturore. 44 Monumete / Zona të përfshira në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura janë përfshirë në këtë listë, ku statusi i veçantë paraqitet në një kolonë të veçantë të listës. Gjithashtu në këtë listë gjenden edhe kishat dhe lokalitetet tjera fetare ortodokse⁵⁵. Nga kategoria e trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore përafërsisht 11% të aseteve paraqesin monumete fetare dhe profane që përfaqësojnë komunitetin serb. Këtu përfshihen lokalitete arkeologjike, kisha, manastire, shtëpi dhe komplekse banimit.

Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme, e cila përfshin gjithsej 23 asete në nivel vendi, përfshin gjithashtu edhe Kishën e Shën Premtes (Bogorodica Ljeviška) në Prizren, Manastirin e Deçanit, Manastirin e Graçanicës dhe Patrikanën e Pejës, të cilët janë përfshirë në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, dhe gjenden në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.⁵⁶

Në Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore (2017-2028) është ri-theksuar diskrecioni i plotë i Kishës Ortodokse Serbe në menaxhimin, qasjen në pronat e saj kulturore, duke përfshirë edhe veprimet e konservimit dhe restaurimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet e Kosovës, si dhe vazhdimi i bashkëpunimit me Këshillin për Zbatim dhe Monitorim dhe Kishën Ortodokse Serbe, si dhe promovimi i veprimeve konkrete dhe i respektit e besueshmërisë si vlera të shtuara.

Krahas kornizës dhe mekanizmave ligjor, trashëgimia kulturore dhe fetare e komunitetit serb, gëzon një kujdes të shtuar përmes mekanizmave institucional, sikur është Këshilli Zbatues Monitorues i cili është përgjegjës për monitorimin dhe asistimin e zbatimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe dispozitave tjera që dalin nga ky ligj. Ky Këshill përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë përfaqësues të MMPH, MKRS, BE, OSCE dhe Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, kurse bashkë-kryesohet nga përfaqësuesi i MMPH dhe BE. Që nga koha e themelimit në vitin 2013, KZM është takuar rregullisht për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.⁵⁷ Raportet e këtij këshilli nuk janë publike.

Akterët tjerë që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të komunitetit serb në Kosovë, janë Policia e Kosovës, e cila ofron sigurimin e lokaliteteve ortodokse përmes Njësisë së specializuar për sigurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe komunat e Kosovës.

2.3. Monumetet mesjetare të Kosovës në UNESCO dhe Lista e Trashëgimisë Botërore

Duke u nisur nga rrethanat tejet jostabile, si rrjedhojë e luftës së vitit 1999 dhe trazirave të Marsit 2004, me lobim intensiv të shtetit serb, në vitin 2004 në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s është regjistruar Manastiri i Deçanit, i propozuar nga shteti palë Serbia⁵⁸. Në vitin 2006 Komiteti i Trashëgimisë Botërore e zgjeron shtrirjen e lokalitetit me përfshirjen e tri kishave tjera, Patriarkanën e Pejës, Manastirin e Graçanicës dhe Kishën Shën Premtes (Bogorodica Ljeviška) në Prizren dhe e vendos në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Rrezik, nën emërtimin "Monumetet Mesjetare në Kosovë"⁵⁹. Shkaqet që kanë ndikuar në vendosjen në Listën në Rrezik ndërlidhen me vështirësitë në menaxhim dhe konservim të këtyre monumeteve si rrjedhojë e jo-stabilitetit politik në rajon.⁶⁰

54 Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Neni 81), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, qasur 20.01.2021

55 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Regjistri_i_Trash%C3%ABgimis%C3%AB_Kulturore_-_Shqip.pdf, qasur 19.01.2021.

56 UNESCO, Medieval Monuments in Kosovo, <https://whc.unesco.org/en/list/724/>, qasur 20.01.2021

57 OSCE, Challenges in the Protection of Immovable Tangible Cultural Heritage in Kosovo, (Prishtinë, 2014), f.12, <https://www.osce.org/kosovo/117276>, qasur 20.01.2021.

58 UNESCO, Medieval Monuments in Kosovo, 2004, <https://whc.unesco.org/en/list/724/>, qasur 21.01.2021.

59 UNESCO, World Heritage Committee puts Medieval Monuments in Kosovo on Danger List and extends sit in Andorra, ending this year's inscriptions, 2006, <https://whc.unesco.org/en/news/268/>, qasur 21.01.2021.

60 Ibid.

Krahas vlerave të jashtëzakonshme universale, si shembuj të jashtëzakonshëm të arkitekturës mesjetare fetare në Evropë⁶¹, dëmtimet e shkaktuara gjatë viteve 1999 e 2004, presioni politik i ushtruar në organizatat ndërkombëtare nga Serbia, dhe raportet e vlerësimit të hartuar nga misioni i ekspertëve të UNESCO-s gjatë viteve 2003-2004, kanë ndikuar në përshejtimin e regjistrimit të këtyre monumenteve në Listën Botërore të Trashëgimisë. Në raportin e vlerësimit të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë, misioni i ekspertëve të UNESCO-s rekomandon përfshirjen e këtyre monumenteve në Listën Botërore të Trashëgimisë duke theksuar se: "Njohja e tillë ndërkombëtare e monumenteve kryesore të Kosovës do të theksonte urgjencën e çështjes për atë që mund t'u japë një mesazh ndaj vandalëve të mundshëm që mund të synojnë shkatërrimin e mëtejshëm të trashëgimisë kulturore."⁶²

Këto katër monumente, që nga viti i regjistrimit vazhdojnë të qëndrojnë në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik, dhe atë sipas UNESCO-S për shkak të: Mungesës së statusit ligjor; Mungesës së mbrojtjes ligjore të zonave mbrojtëse; Mungesës së zbatimit të Planit të Menaxhimit dhe menaxhimit aktiv; Vështirësive për monitorimin e pronave për shkak të jo-stabilitetit politik; dhe Gjendjes jo të kënaqshme të konservimit dhe mirëmbajtjes së monumenteve.

Duhet të theksohet se që nga procesi i propozimit, regjistrimi dhe raportimi vjetor, prezantimi i të gjeturave në lidhje me gjendjen e këtyre monumenteve zhvillohet ndërmjet UNESCO-s dhe shtetit palë, në këtë rast Serbisë. Mënyra e vetme e komunikimit me Kosovën, bëhet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e monumenteve, edhe atë vetëm përmes UNMIK-ut dhe BE-së⁶³. Në raportimet vjetore rreth gjendjes së konservimit, është vërejtur që misioni i UNESCO-s ka komunikuar rregullisht me UNMIK-un në lidhje me çështjet e sigurisë të ngritura nga shteti palë (Serbia). Në raportin e vitit 2007 është shënuar hartimi i Ligjit për trashëgiminë Kulturore nga Kuvendi i Kosovës, dhe për përcaktimin e termit "Zonë mbrojtëse" rreth monumenteve, e cila është vlerësuar që nuk mjafton për ruajtjen e pronave të Trashëgimisë Botërore,

duke u kërkuar vendosja e masave më konkrete për zonat mbrojtëse.⁶⁴ Në raportimet e viteve të ardhshme fare nuk përmenden masat dhe mekanizmat ligjor shtesë që vendosen nga institucionet e Kosovës për monumentet e trashëgimisë fetare, përmes aprovimit dhe themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura, ku përfshihen edhe katër monumentet e listuara në Listën e Trashëgimisë Botërore. Dispozitat ligjore të Zonave të Veçanta të Mbrojtura mund të vlerësohen si masa konkrete për ruajtjen e integritetit të monumenteve të lartpërmendura.

Statusi i Zonave të Veçanta të Mbrojtura ofron mbrojtjen dhe lirinë e plotë në menaxhimin e pronave nga Kisha Ortodokse Serbe, ku institucionet dhe autoritetet e Kosovës kanë qasje të kufizuara, ku një qasje e tillë mund të ofrohet vetëm me pëlqimin e dhënë nga Kisha Ortodokse Serbe.⁶⁵

Pa një ulëse në organizatën e UNESCO-s, dhe me kufizimet e përcaktuara në baza ligjore, institucionet e trashëgimisë kulturore në Kosovë, në një mënyrë i kanë duart e lidhura në aspektin e kontributit, dhe përfaqësimit të opinionit profesional në lidhje me gjendjen e konservimit të monumenteve në Listën e Trashëgimisë Botërore, të cilët gjenden në territorin e Kosovës. Sidoqoftë, edhe pse Kosova ende nuk është anëtarësuar në UNESCO, kontributi i kësaj organizate, në promovimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe të diversitetit kulturor në Kosovë, ka qenë i një rëndësie thelbësore. Në konferencën ndërkombëtare të donatorëve, të organizuar nga UNESCO në bashkëpunim me UNMIK-un, Këshillin e Europës dhe Komisionin Europian, në vitin 2005⁶⁶ është prezantuar lista e monumenteve të rrezikuara, e cila përfshinte 48 monumente Ortodokse, 14 monumente Islame / Osmane, dhe 13 shembuj të arkitekturës popullore. Nga kjo listë, krahas investimeve në monumentet Ortodokse, janë hartuar dhe zbatuar projekte të restaurimit edhe për disa monumente tjera: Hamami i Gazi Mehmed Pashës në Prizren⁶⁷, Katedralja Katolike e Zonjës Ndihiçtare në Prizren, Kalaja e Novobërdës. Komunikimi ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe përfaqësuesve të UNESCO-s është realizuar përmes ndërmjetësimit të BE, OSCE dhe zyres regionale të UNESCO-s në Sarajevë⁶⁸.

61 UNESCO, Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo, <http://erc.unesco.org/seeconference>, qasur 18.01.2021.

62 UNESCO, Cultural Heritage in South East Europe: Kosovo, Mission Report 26-30 April 2004, Cultural Heritage in South-East Europe Series No.2, http://portal.unesco.org/en/files/20053/10827207031Pages_1-14_KOSOVO_report_distilled.pdf/Pages+1-14+KOSOVO_report_distilled.pdf, qasur 13.1.2021.

63 UNESCO, State of Conservation, Medieval Monuments in Kosovo (Serbia), <https://whc.unesco.org/en/soc/3518>, qasur 21.01.2021.

64 UNESCO, State of Conservation 2007, Medieval Monuments in Kosovo (Serbia), <https://whc.unesco.org/en/soc/956>, qasur 21.01.2021

65 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 2007, <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Final%20Settlement%20Proposal%20AL.pdf>, qasur 20.01.2021.

66 <https://news.un.org/en/story/2005/05/137562-unesco-host-donors-conference-cultural-heritage-kosovo>, qasur 11.03.2021.

67 Restaurimi i Hamamit të Prizrenit, <https://telegrafi.com/restaurimi-i-hamamit-te-prizrenit-ky-eshte-sqarimi-i-qendres-rajonale-per-trashegimi-kulturore/>, qasur 11.03.2021.

68 <https://en.unesco.org/news/official-launch-revitalization-novob-C3%ABrd%C3%ABnovo-brdo-fortress-project>, qasur 11.03.2021.

Në vitin 2015 tentimi i Kosovës për tu anëtarësuar në UNESCO dështoi për tri vota. Ky proces u manifestua me konfrontim diplomatik për të pretenduar të drejtat mbi sovranitetin dhe identitetin kombëtar. Në këtë kontekst diskutimi rreth anëtarësimit në një organizatë ndërkombëtare për edukim, shkencë dhe kulturë, u ngushtua dhe u fokusua vetëm në pretendimet e legjitimitetit mbi të drejtat mbi trashëgiminë kulturore, duke u politizuar skajshëm. Plotësimi i bazës funksionale ligjore, sikurse aprovimi i ligjit të ri për trashëgiminë kulturore dhe ligjit mbi liritë fetare, është një prej parakushteve që duhet të plotësohet nga institucionet e Kosovës, para se të paraqitet për herë të dytë aplikimi në UNESCO⁶⁹. Duke ju referuar faktit që ligjet mbi trashëgiminë kulturore janë ligje me interes vital, ku kërkohet votimi nga shumica e dyfishtë e deputetëve të parlamentit të Kosovës, edhe këtu paraqitet problematika e politizimit të kësaj fushe.

Shikuar në aspektin profesional të vlerësimit të trashëgimisë kulturore si vlerë e përbashkët universale, në Kosovë ekzistojnë lokalitete të trashëgimisë kulturore që mund të plotësojnë kriteret që bazohen në konceptin e identifikimit të Vlerës së Dalluar Universale, që nënkuptojnë vlerat të cilët veçohen si tipare reprezentative për gjithë njerëzimin. Prizreni si një prej qyteteve historike më të spikatura, i cili ngërthen në vete dëshmi materiale dhe jo-materiale të civilizimeve dhe kulturave të kaluara, ku struktura historike e qytetit luan një rol të rëndësishëm frymëzues në formësimin e ambientit të së nesërme⁷⁰; Prizreni është vendi i themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili paraqet ngjarjen me rëndësi historike ku, për herë të parë qytetarët e territoreve të banuara me shqiptarë u bashkuan për të shprehur kërkesën themelore dhe universale për vetëvendosje dhe për ruajtjen nga copëtimi i territoreve të banuar me shqiptarë. Vlera universale e shprehur këtu është rëndësia e një ngjarjeje, ideje dhe besimi për të drejtën e vetëvendosjes së një kombi.⁷¹ Komplekset e banimit të kullave të gurit që përfshijnë pjesën jug-perëndimore të Kosovës, të cilët mund të zgjerohen në kullat verilindore të Shqipërisë, dhe mund të propozohen në trajtë të nominimit përtej kufitar, si peizazhe kulturore⁷²; Çarshitë e vjetra

të vendosura përgjatë itinerareve tregtare, ku ndërthuret bashkëveprimi shoqëror ndërmjet rrugëve, urave, objekteve ekonomike, dhe strukturave të akomodimit të cilët janë ruajtur në Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Vushtrri, duke e veçuar shembullin e Çarshisë së Vjetër të Gjakovës, i cili krahas faktit që ka përjetuar dëmtime serioze gjatë luftës 1999, ka arritur të ruajë integritetin;⁷³ Qytetet minerare (sikurse Novobërda, Trepça) mund të klasifikohen në kuadër të Itinerareve Kulturore⁷⁴; janë disa nga shembuj të ilustruar dhe të vlerësuar edhe nga autorët e huaj, duke mos e anashkaluar edhe trashëgiminë e pasur shpirtërore.

Politizimi i procesit të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO duke u fokusuar vetëm në çështjen e monumenteve fetare ortodokse, dhe duke anashkaluar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore që nuk janë ortodokse, bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme ndërkombëtare ku ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore është interes i përbashkët i njerëzimit, që shkon përtej sovranitetit të shteteve.⁷⁵

69 Morina Die, Kosovo Mulls Renewed Bid to Join UNESCO, në Balkan insight, 2017, <https://balkaninsight.com/2017/02/23/kosovo-mulls-second-unesco-bid-02-23-2017/>, qasur më 21.01.2021.

70 MKRS, "Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit 2019-28", f.26-29, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40669>, qasur 21.01.2021.

71 Ibid.

72 Klein, Caroline Jaeger, "UNESCO World Heritage and Kosovo towards a Tentative List for Kosovo", në UBT International Conference, (Prishtinë, 2016), f. 60-62, <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2016/all-events/65>, qasur 21.01.2021.

73 Ibid.

74 Ibid.

75 Francioni, Francesco, "Beyond State Sovereignty: The Protection of Cultural Heritage as a Shared Interest of Humanity" në Michigan Journal of International Law, (2004), f.1209-1226, <https://repository.law.umich.edu/mjil/vol25/iss4/21>, qasur më 21.01.2021.

3. SHEMBUJT E TRAJTIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË

Pas kontekstit historik dhe analizës së bazës dhe mekanizmave ligjor ekzistues, në vijim do të paraqitet një pasqyrim kronologjik i shembujve të trajtimit të trashëgimisë kulturore të komunitetit serb, pas periudhës së luftës së vitit 1999 dhe trazirave të Marsit të vitit 2004.

Në këtë pjesë do të paraqiten shembuj pozitiv ku vlerat e trashëgimisë kulturore kanë shërbyer si mjet bashkërendimi, për njohjen dhe respektimin e identiteteve dhe kulturave të komuniteteve të ndryshme të cilët veprojnë në një territor të përbashkët. Këto praktika pozitive duhet të promovohen dhe të përdoren si shembuj për qasjen e cila duhet të vazhdojë të praktikohet edhe në të ardhmen. Tek shembujt e ilustruar janë paraqitur edhe të dhënat rreth aktorëve kryesor, iniciuesit, bartësit dhe financuesit e këtyre projekteve.

Lista përmban edhe raste negative të menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë së komunitetit serb të shkaktuar nga faktorë të ndryshëm. Këta shembuj shërbejnë si model reflektues dhe nxjerrje mësimi që këto raste në të ardhmen të mos përsëriten.

Ky kapitull nuk synon të jetë raport zyrtar apo një listë e plotë e projekteve dhe investimeve, por mëton pasqyrimin e gjendjes reale në terren dhe raportim profesional e më

të balancuar në krahasim me raportet mediale shpesh të njëanshme apo edhe të pakonfirmuara.

3.1 Komisioni për Rindërtim dhe Zbatim (2004)

Pas dëmtimeve të shkaktuara gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, si përgjigje për të ofruar një zgjidhje për rehabilitimin e monumenteve të dëmtuara, një nga veprimet e menjëhershme ishte themelimi i Komisionit për Rindërtim dhe Zbatim (KRZ).⁷⁶ Ky Komision u themelua në të njëjtin vit dhe ka shërbyer si mjet zbatimi për rindërtimin e Kishave Ortodokse Serbe. KRZ ka siguruar një platformë unike për dialog midis palëve të interesuara të Kosovës dhe Serbisë, përfshirë Kishën Ortodokse Serbe, në mënyrë që të kapërcehen vështirësitë specifike të lidhura me situatën politike me një interes të sigurtë e përpjekje nga të gjitha palët. Themelimi i këtij mekanizmi ka qenë në mbështetje të zbatimit të Agjendës Evropiane të Kosovës, përkatësisht respektimin e të drejtave të komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik.

Me iniciativë dhe ftesë të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në procesin e vlerësimit të dëmeve kanë marrë pjesë përfaqë-

⁷⁶ Council of Europe, Reconstruction Implementation Commission for Serbian Orthodox Religious sites in Kosovo*, 2011, https://issuu.com/councilofeurope/docs/ric_for_serbian_orthodox_religious_sites_in_kosovo, qasur 27.01.2021.

sues të UNESCO-s, Komisionit Evropian (KE) dhe Këshillit të Evropës (KiE). Ky proces rezultoi me hartimin e një "Plan Veprimi Emergjent për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë", si mjet shtesë në kuadër të programit që veçse ishte në zbatim "Programit Rajonal për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore në Evropën Juglindore". Në kuadër të këtij Komisioni, gjithsej tri misione të përbashkëta të vlerësimit teknik u organizuan nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian nga muajt Maj – Korrik 2004. Misionet e vlerësimit teknik, krahas ekspertëve të angazhuar nga Këshilli i Evropës, Komisionit Evropian, kanë përfshirë edhe ekspertët nga institucionet e përkohshme të Kosovës, institucionet e Serbisë dhe përfaqësues të Kishës Ortodokse Serbe. Si rezultat i negociatave të ndërmjetësuara nga UNMIK-u është arritur nënshkrimi i Memorandum Bashkëpunimit ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe Institucioneve të përkohshme të Kosovës, për themelimin Komisionit për Rindërtim dhe Zbatim. Në kuadër të këtij komisioni ka vepruar Bordi i Ekspertëve Ndërkombëtar, dhe Njësia Teknike e përbërë nga përfaqësues të: Këshillit të Evropës, Kishës Ortodokse Serbe, Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Beograd, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prishtinë, dhe një përfaqësues nga UNMIK-u.⁷⁷

Në kuadër të punës dhe angazhimit të këtij komisioni nga viti 2004 janë zotuar gjithsej:

- 6,9 Milion Euro nga Kuvendi i Kosovës;
- 1,6 Milion Euro nga Bashkimi Evropian për të menaxhuar dhe përfunduar punimet e rindërtimit në dy nga lokalitetet prioritarë të KRZ-së në Prizren;
- 205.000 Euro nga UNESCO për të menaxhuar dhe rindërtuar tërësisht Kishën e Shën Mikelit në Shtime dhe Kishën e Shën Savës në Mitrovicën Veriore.
- Për më tepër, në 13 maj 2005, nga UNESCO, në bashkëpunim të ngushtë me UNMIK, KiE dhe BE, u organizua një konferencë donatorësh në Paris, me qëllim të sigurimit të fondeve për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Gjatë kësaj konference u siguruan fonde shtesë për projektet e zbatuara nga UNESCO paralelisht me procesin e Komisionit për Rindërtim dhe Zbatim.



Foto 3: Kisha e Shën Andrej në Podujevë (para dhe pas rindërtimit)
Burimi: RIC

Bazuar në prioritetet e definuara nga KRZ në bashkëpunim me Kishën Ortodokse Serbe, nga viti 2005 janë realizuar arritjet e mëposhtme, duke promovuar mundësinë që këto lokalitete të ruhen edhe për të ardhmen dhe përmes funksionalizimit të bëhen pjesë e komuniteteve që ju takojnë.⁷⁸

- 30 lokalitete - të konservuara, të konsoliduara dhe të mbrojtura, në kuadër të ndërhyrjeve emergjente në 2005;
- 21 kisha kanë përfunduar plotësisht punimet në pjesët e jashtme, dhe disa punime në enterier të përfunduara*;
- 2 konakë të manastireve (shtëpi pritjeje) janë rindërtuar dhe janë të banueshme;
- 8 shtëpi të priftërinjve janë rindërtuar plotësisht dhe janë të banueshme;
- 2 pagëzimore janë restauruar,

⁷⁷ Council of Europe, Reconstruction Implementation Commission for Serbian Orthodox Religious sites in Kosovo*, 2011, https://issuu.com/councilofeurope/docs/ric_for_serbian_orthodox_religious_sites_in_kosovo, qasur 27.01.2021, f.11-12.
⁷⁸ Ibid.

* Dy nga këto 21 kisha janë rindërtuar me fonde nga UNESCO.

** Punimet në njërin nga këto tre ndërtesa janë kryer nga Bashkimi Evropian;

*** Punimet në këtë ndërtesë janë kryer nga Bashkimi Evropian.

- 3 kulla këmbanore janë rindërtuar dhe riparuar (përfshi instalimin e këmbanave);
- shkolla fetare janë rindërtuar**;
- 3 ndërtesa ndihmëse shërbyese janë riparuar dhe rindërtuar;
- 3 mure rrethuese janë riparuar ose rindërtuar; 1 rezidencë e peshkopit është e rindërtuar dhe e banueshme***.

3.2 Punët restauruese dhe iniciativat për turizëm rural në fshatin Hoçë e Madhe, Rahovec (2004)

Fshati Hoçë e Madhe shtrihet në pjesën jugore të qytetit të Rahovecit, përafërsisht 20 km në perëndim të Prizrenit. Fshati ka një popullsi rreth 700 banorë të komunitetit serb. Dokumentet e para të shkruara datojnë nga periudha e mesjetës kur edhe konsiderohet se gjatë kësaj periudhe Hoça e Madhe u bë qendër e madhe tregtare dhe kulturore. Fshati ka trashëguar një koleksion të pasur të ndërtesave me interes historik dhe kulturor përfshi edhe zhvillimin e zejeve, prodhimin e verës dhe bujqësinë. Vlen të potencohet se fshati ka trembëdhjetë kisha mesjetare dhe shtëpi të vjetra guri që shtrihen në luginë të rrethuar nga vreshtat, bujtina të shumta private, verari dhe mullinj me ujë.⁷⁹



Foto 4: Shtëpia Saraj pas restaurimit (Burimi: GAIA Kosovo)

Fshati Hoçë e Madhe është Zonë e Veçantë e Mbrojtur, ku ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore rregullohen përmes ligjit të veçantë.⁸⁰ Ky fshat shkak i rëndësisë së jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore që posedon ka qenë në fokus të partnerëve të ndryshëm lokal e ndërkombëtar në ruajtjen dhe promovimin e turizmit rural. Disa nga shembujt e investimeve që janë kryer mund të listohen në vijim:

- Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë Saraj – E klasifikuar si një aset në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje, kjo ndërtesë është restauruar dhe është hapur për shfrytëzim për komunitetin. Kati i parë shërben si qendër rinore, ndërsa kati përdhës shfrytëzohet si një galeri arti. Projekt i zbatuar nga CHWB Kosova dhe financuar nga Swedish Development Agency (SIDA).
- Restaurimi i Kullës Kujunxhiq – Kjo ndërtesë me arkitekturë tipike të kullave të Rrafshit të Dukagjinit është e karakterit monumental ka edhe funksion të mauzoleut. Kulla gjithashtu është restauruar nga projekti i zbatuar nga CHWB Kosova dhe financuar nga SIDA.
- Katër shtëpi tradicionale të konvertuara në bujtina (Shtëpia e familjes Pantiç, Kostić, Manitasheviç dhe Spasiç) që ofrojnë shërbime shtrat dhe mëngjes.⁸¹
- Restaurimi i Kishës së Shën Stefanit. Projekt i zbatuar nga International Relief & Development (IRD)
- Restaurimi i verarisë së kishës Shën Stefanit, ndërtesë e cila është restauruar dhe adaptuar në qendër komuniteti dhe pritjeje për mysafirë.⁸² Projekt i zbatuar nga CHWB Kosova dhe financuar nga Fondi i Ambasadorëve të SHBA-ve për Mbrojtjen e Vlerave Kulturore.

3.3 Aktet e vandalizmit ndaj Kishës Ortodokse Serbe dhe gjendja e lirive fetare në Kosovë (2007)

Lokalitetet e Kishës Ortodokse Serbe ishin shënjestër të dhunës me motive etnike gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, gjë që çoi në dëmtimin e rëndë të kishave dhe manastireve. Pas vitit 2004 kërcënim ndaj sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore përbëjnë kryesisht rastet e sulmeve, vandalizmit dhe vjedhjeve.⁸³ Krahës sigurimit të këtyre lokaliteteve nga Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës,

⁷⁹ Cultural Heritage without Borders, Velika Hoca/Hoçë e Madhe Bed & Breakfast, (CHWB, 2010), <https://chwb.org/wp-content/uploads/2014/02/Bed-and-Breakfast-Velika-Hoca.pdf>, qasur 27.01.2021.

⁸⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2835>, qasur 27.01.2021.

⁸¹ Cultural Heritage without Borders, Velika Hoca/Hoçë e Madhe Bed & Breakfast, (CHWB, 2010), <https://chwb.org/wp-content/uploads/2014/02/Bed-and-Breakfast-Velika-Hoca.pdf>, qasur 27.01.2021.

⁸² <https://www.facebook.com/CHWBKosova/photos/a.649310805100755/937664626265370/?type=3>, qasur 26.01.2021.

⁸³ OSCE, Challenges in the Protection of Immovable Tangible Cultural Heritage in Kosovo, (Prishtinë, 2014), faqe 21–22, <https://www.osce.org/kosovo/117276>, qasur 20.01.2021.

me përjashtim të dy Manastireve (Manastiri i Deçanit dhe Patrikana e Pejës) të cilët vazhdojnë të ruhen nga KFOR-i, raste të sulmeve në ndërtesat ortodokse, duke mos përjashtuar edhe sulmet në ndërtesat fetare tjera (myslimane, katolike, protestante) vazhdojnë të raportohen dhe të paraqesin rrezik. Në vijim do të pasqyrohen dhe citohen disa nga raportimet rreth sulmeve të paraqitura, në mënyrën se si janë paraqitur dhe trajtuar nga institucione të niveleve të ndryshme, lokale dhe ndërkombëtare.

➤ **Një vit para përcaktimit të statusit të Kosovës, në 2007 në afërsi të Manastiri i Deçanit kishte raportime për një mjet shpërthyes. Shpërthimin në një distancë prej rreth njëmijë metrash larg manastirit të Deçanit, e konfirmoi edhe Shërbimi Policor i Kosovës, i cili pas një kontrolli të detajuar në terren ka gjetur një kornizë të zbrazët granatahedhësi si dhe pranë murit të jashtëm, është gjetur një predhë tjetër e pashpërthyer, e cila është larguar nga forcat e KFOR-it.⁸⁴ Sipas zëdhënësit Janjiç, është fjala për një granatë anti-tank në gjatësi prej 64 milimetrash, e cila për shkak të trashësisë së murit mesjetar të manastirit, nuk ka shkaktuar ndonjë dëm të dukshëm.**

"Është fjala për njerëz, të cilët përdorin armë kundër një monumenti kulturor të UNESCO-s, të cilët nuk ia duan të mirën popullit dhe të cilët nuk e shohin të ardhmen në një Kosovë të qetë, ku do t'sundojë drejtësia dhe ligji. Ekstremistë të tillë do duhej të izolohen, ndërsa populli t'i përmbahet traditës, ashtu siç ditën ta ruajnë këtë vend me shekuj"-thotë zëdhënësi i Manastirit të Deçanit, Sava Janjiç.

Kryetari i Komunës, Nazmi Selmanaj, e dënon këtë akt si dhe të gjitha sulmet që do të dëmtonin procesin nëpër të cilin po kalon Kosova. "Kjo goditje nuk është vetëm ndaj manastirit, por është kundër institucionit komunal, kundër Kosovës dhe të gjitha përpjekjeve që po bëhen nga Bashkësia Ndërkombëtare, për zgjedhjen e statusit të Kosovës. Ky akt ndodh në kohën kur më së tepërmi kërkohet paqe e qetësi!" Komuna e Deçanit ofroi edhe shpërblim prej 2 mijë eurosh për atë që do të japë informacione lidhur me shpërthimin në afërsi të manastirit të Deçanit.

➤ **Gjatë vitit 2014 Manastiri i Deçanit ishte cak i sulmeve me mbishkrime si: "Kalifati po Vjen", "ISIS", "AKSH", "UÇK". Fotografitë me këto grafitë i ka publikuar në Twitter igumeni i Manastirit të Deçanit, Sava Janjiç. Policia e Kosovës në rajonin e Pejës ka konfirmuar se ka marrë një informatë për këto mbishkrime dhe ka dalë në vend të ngjarjes. "Për momentin nuk kemi asnjë të dyshimtë, por ne kemi kryer të gjitha veprimet policore", tha për KALLXO.com, zëdhënësi rajonal i policisë, Xhevat Ibraj. Ai nuk mundi të konfirmojë nëse ka kamera të sigurisë në tërë perimetrin e Manastirit. Por këto mbishkrime kanë ngjallur menjëherë reagimin e drejtuesve të institucioneve të Kosovës.⁸⁵**

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga tha në një reagim se "vandalizimi i një monumenti të trashëgimisë kulturore dhe të karakterit fetar nuk i kontribuon ndërtimit të mirëbesimit mes komuniteteve dhe bie ndesh me vlerat e tolerancës ndërfaqetare dhe etnike që janë vënë në gurthemelin e shtetit të Kosovës".⁸⁶



Foto 5: Mbishkrimet në ndërtesat ndihmëse të Manastirit të Deçanit (Burimi: Kallxo.com)



Foto 6: Mbishkrimet në ndërtesat ndihmëse të Manastirit të Deçanit (Burimi: Zeri i Amerikes)

84 Beqiraj Ajete, Dënohet sulmi mbi Manastirin e Deçanit, në DW, 2007, <https://www.dw.com/sq/d%C3%ABnohet-sulmi-mbi-manastirin-e-de%C3%A7anit/a-2589057>, qasur 27.01.2021.

85 Zogjani Nektar, Grafitet në Manastirin e Deçanit ngjallin zemërim, në Kallxo.com, 2014, <https://kallxo.com/gjate/grafitet-ne-manastirin-e-decanit-ngjallin-zemerim/>, qasur 27.01.2021.

86 Voice of Amerika, Grafitet në Manastirin e Deçanit, 2014, <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-graffiti/2481374.html>, qasur 27.01.2021.



Foto 3: Udhëheqës të Bashkësisë Islame të Kosovës vizitojnë Manastirin e Deçanit (Burimi Zeri i Amerikës)

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi tha në një deklaratë në rrjetet sociale se “fillimisht duhet të dënojmë një incident të tillë sepse objekti i Manastirit të Deçanit nuk është vetëm mur por trashëgimi e mbrojtur me ligje të Republikës dhe ka statusin si një vlerë të njohur botërore edhe nga UNESCO. Për më shumë, grafitë me mesazhe të tilla janë edhe kundër vlerave më të shenjta të luftës për çlirimin e Kosovës. UÇK kurrë nuk ka luftuar për çështje fetare por emancipuese në frymën evropiane. Për dallim nga shtetet e tjera ballkanike që kanë pasur njësitë xhihadiste apo ekstremiste pan-ortodokse, ne kemi zhvilluar një luftë të ndihmuar nga aleanca më e madhe në botë NATO. Dora e atij që fut në një fjali UÇK dhe ISIS nuk është dorë që ua do të mirën shqiptarëve, pakicave dhe Kosovës”, thuhet në reagimin e zotit Thaçi.⁸⁷

Gjatë një takimi ndërmjet udhëheqësve të Bashkësisë Islame të Kosovës me udhëheqësit e Manastirit të Deçanit më 22 tetor 2014, thuhet se një “akt i tillë dëmton përpjekjet e bashkësive fetare për të kultivuar tolerancën e mirëkuptimit ndër-fetar e ndëretnik”. Në një komunikate për opinion të Bashkësisë Islame të Kosovës thuhet se “ky akt është i papranueshëm, i dënueshëm dhe kundër çdo mësimi dhe tradite fetare në Kosovë. Sulmi ndaj objekteve fetare e kulturore është vepër e kryer nga ata që nuk ia duan të mirën vendit dhe popullit të Kosovës. Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar për kultivimin e tolerancës e mirëkuptimit në vendin tonë”.⁸⁸

➤ Një nga shqetësimet tjera në lidhje me komunitetin fetar serb ortodoks por edhe ato të konfesionëve tjera ka të bëjë me respektin shoqëror për liritë fetare. Në Raportin Ndërkombëtar të Lirisë Fetare për vitin 2019 të Departamentit të Shteteve të Bashkuara⁸⁹ citohet:

“Policia kombëtare raportoi 61 incidente të motivuara fetarisht në nëntë muajt e parë të vitit, shumica e të cilave shënjestruan vendet fetare ortodokse dhe myslimane dhe përfshinë vjedhje ose dëmtime të pasurisë, të tilla si përdhosja e varrezave, krahasuar me 86 raste të një natyre të ngjashme në 2018. Pasi që etnia dhe feja shpesh janë të lidhura ngushtë, ndonjëherë ishte e vështirë të kategorizoheshin incidentet si të bazuara vetëm në identitetin fetar.....

Më 6 janar, sipas Kishës Ortodokse Serbe (KOS), një grup shqiptarësh të Kosovës abuzuan verbalisht priftin e KOS Bojan Jevtic, duke e quajtur atë “çetnik” dhe e kërcënuan ta therrnin atë para kishës së tij në Komunën e Novobërdës. Sipas Jevtic, pasi ai bëri një ankesë, policia nuk ndoqi më tej rastin.

Më 6 janar, një grup shqiptarësh të Kosovës, përfshirë familjet e personave të zhdukur, protestuan kundër vizitës së paralajmëruar vjetore të Krishtlindjeve Ortodokse të pelegrinëve Ortodoksë Serbë në kishën lokale të KOS në Gjakovë. Pelegrinët u informuan për protestat e paralajmëruara dhe anuluan vizitën e tyre për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Protesta përfundoi pasi protestuesit vendosën një listë të kriminelëve serbë të pretenduar të luftës në derën e kishës, duke deklaruar se ishin kundër “kriminelëve të maskuar si pelegrinë”.

KOS tha se raportimi i medias kontribuoi në një klimë të intolerancës ndëretnike dhe ndërfetare gjatë vitit. KOS gjithashtu u ankua në lidhje me deklaratat publike të OJQ-së “Historianët e Deçanit” kundër igumenit të Manastirit të Deçanit At Sava Janjiç dhe Peshkopit të Rashkës-Prizrenit Teodosije Sibalic...

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) tha se frekuenca e raporteve dhe deklaratave të mediave anti-muslimane u rrit në rrjetet sociale, dhe sekularistët përdorën mediat dhe rrjetet sociale për të portretizuar myslimanët negativisht. Një kolumnist i gazetave u referohej myslimanëve pro-Erdogan si “të prapambetur”, “plehra” dhe “Talibanë”.

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ Voice of Amerika, Udhëheqës të Bashkësisë Islame të Kosovës vizitojnë Manastirin e Deçanit, 2014, <https://www.zerierikes.com/a/bik-kosova-decan-grafite-manastir/2491730.html>, qasur 27.01.2021.

⁸⁹ Ambasada e SHBA-së në Kosovë, Raporti për Liritë Fetare, <https://xk.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/>, qasur 27.01.2021.



Drejtuesit e grupeve fetare vazhduan të takoheshin herë pas here për diskutime ndërfetare mbi të drejtat e pronës, përparësitë legjislative dhe çështjet e bashkësisë lokale. OSBE-ja vazhdoi të koordinojë disa aktivitete midis grupeve fetare, përfshirë takimet me autoritetet qendrore dhe lokale, për të diskutuar çështje të tilla si lejet për ndërtimin e ndërtesave fetare. OSBE gjithashtu përfshiu përfaqësues të gjitha bashkësisë kryesore fetare në këshillat komunalë të sigurisë në bashkësi, të cilët u takuan për të diskutuar çështje të sigurisë.”⁹⁰

Me këtë peticion po bëhet një presion ndaj autoriteteve komunale të Prishtinës që janë përgjegjëse për dhënien e lejes urbanistike për ndërtimin e xhamisë në lokacionin e ndarë nga po kjo komunë, me një kryetar tjetër... ”.

91 Gazeta Infokus, KMDLNJ: Standarde të dyfishta edhe në fushën e të drejtave dhe lirive fetare, 2017, <https://gazetainfokus.com/kmdlNJ-standarde-te-dyfishta-edhe-ne-fushen-e-te-drejtave-dhe-lirive-fetare/>, qasur 27.01.2021.



Foto 4: Patrikana e Pejës para dhe pas fasadimit (Burimi: <https://ndertimi.info/>)

3.4 Ngjyrosja e fasadës dhe ndërtimi i mureve rrethuese të Patrikanës së Pejës (2008 – 2010)

Punimet restauruese në fasadë dhe punët e ndërtimit të mureve rrethuese në Patrikanën e Pejës nuk kishin kaluar nëpër procedura për aprovim nga autoritetet lokale të Komunës së Pejës, as ato qendrore të MKRS-së. Për rastin e

fasadimit të Patrikanës së Pejës është e çuditshme se për një intervenim të tillë nuk është raportuar as në UNESCO ku në raportet e tyre rreth gjendjes së konservimit, ceket se: "Misioni vuri re se fasadat e tre kishave janë ringjyrosur kohët e fundit me ngjyrë të kuqe të errët. Asnjë informacion mbi këtë zhvillim nuk u mor nga Qendra e Trashëgimisë Botërore në përputhje me Paragrafin 172 të Udhëzimeve Operative"⁹².

⁹² UNESCO, State of conservation of World Heritage properties inscribed on the List of World Heritage in Danger WHC-13/37.COM/7A, 2010, <https://whc.unesco.org/en/soc/956>, qasur 21.01.2021



Sa i përket këtij projekti, historiani dhe njohësi i historisë mesjetare Prof.Dr. Jahja Drançolli në mediat lokale kishte deklaruar se: "Kemi të bëjmë me një politikë shumë tinëzare, përmes propagandës së tyre po

shfrytëzohet prezantimi i vetëm një versioni të historisë. Ata në njëfarë mënyre janë arbitrare e paraqesin vetëm të vërtetën e tyre. Këtu duhet të ndërmerren masa pasi që Patrikana e Pejës drejtpërsëdrejti është nën mbrojtjen e UNESCO-s atëherë duhet të tërhiqet vëmendja që të tregohet ajo që është shkencore e jo ana e politikës serbe. Në këtë kontekst duhet të ngritët zëri edhe i institucioneve tona edhe i institucioneve botërore sepse tashmë është trashëgimi botërore që shihet nga gjithë bota".⁹³

Për parregullsi të procesit është prononcuar edhe Shefi i Kabinetit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS), Samir Hoxha: "Patrikana e Pejës gjendet në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përherëshme të Republikës së Kosovës, e klasifikuar edhe si zonë e veçantë me Ligjin Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Kjo strukturë gjendet në kategorinë Trashëgimi arkitekturore, nënkategorinë A. Monument Ansambël. Në një situatë të tillë lejimi apo jo i veprimtarive konservuese – restauruese dhe çdo lloj intervenimi, i nënshtrohet regjimit mbrojtës të përcaktuar me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura".⁹⁴

Punimet e murit rrethues të vitit 2010 u paraprinin përgatitjeve për zyrtarizmin, sipas kërkesës së tij, të punës së Patriarkut të ri të Kishës Ortodokse Serbe, Irinej Gavriloviçit, i cili kishte ndodhur më 3 tetor të këtij viti.⁹⁵ Në lidhje me punimet e ndërtimit të mureve rrethuese, Kryetari i Pejës, Ali Berisha, kishte deklaruar se Patrikana e Pejës as kësaj here nuk ka kërkuar leje ndërtimi për murin që po bëhet buzë Lumit të Bardhë. "Vendi në të cilin Patrikana është duke ndërtuar këtë mur është zonë e mbrojtur. Pavarësisht kësaj kërkohet respektimi i ligjeve në fuqi, d.m.th. kërkohet që ndërtimet të bëhen me lejen e Kuvendit Komunal", ka thënë Berisha. Derisa Berisha shprehet i pakënaqur që autoritetet e Patrikanës, edhe përkundër raporteve tashmë të vëna me KK-në, janë duke ndërtuar pa lejen e institucionit komunal, drejtori i QRTK Peja, Avdyll Hoxha, thotë se Instituti Rajonal për mbrojtjen e trashëgimisë kulturo-historike, të cilin ai drejton, nuk

është informuar për ndërtimet e reja. Hoxha ka pranuar të jetë informuar "miqësisht" vetëm gojarisht për këtë ndërtim nga një autoritet i UNESCO-s, nën mbrojtjen e të cilit është kjo godinë kulturi.

3.5 Mbështetja e Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (2009-15)

Programi i përbashkët "Mbështetja e Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PCDK)" faza I dhe II, u hartua si vazhdimësi e programit të përbashkët i cili ka filluar me Komisionin për Rindërtim dhe Zbatim (KRZ). Ky program u zhvillua ndërmjet viteve 2009-2015, me një qasje ndërsektoriale dhe të integruar, e zhvilluar në katër komponentët kryesorë: zhvillimi i kapaciteteve, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut, zhvillimi ekonomik lokal dhe mirëqenia e komunitetit, ku të gjithë elementët u bashkuan në veprime inovative bazuar në trashëgiminë e përbashkët. Në këto nisma, të gjithë aktorët, nga niveli bazë në nivelin qendror, morën role dhe përgjegjësi thelbësore. Këtu vlen të përmendet përfshirja e institucioneve të niveleve qendror (si MKRS dhe Qendrat Rajonale përkatëse të Trashëgimisë Kulturore respektive), niveli komunal (komunat e ndryshme partnere) dhe OJQ-të e ndryshme aktive dhe multietnike dhe komunitetet fetare të ndryshme.



Foto 5: Pamje nga vizitat edukative me përfitues të grupe të ndryshme të interesit (Burimi: CHwB Kosovo)

⁹³ Desku Arta, Patrikana e Pejës mes versioneve kontradiktore të historisë dhe fasadës që "duhet dënuar" në Ndërtimi, 2019, <https://ndertimi.info/arkiva/patrikana-e-pejes-mes-versioneve-kontradiktore-te-historise-dhe-fasades-qe-duhet-denuar/> qasur 26.01.2021.

⁹⁴ Ibid.

⁹⁵ Koha Ditore, Patrikana e Pejës ngreh edhe një mur pa leje të Komunës së Pejës, 2010, <http://www.arkivalajmeve.com/Patrikana-e-Pejes-ngreh-edhe-nje-mur-pa-leje-te-Komunes-se-Pejes.1046920438/> qasur 27.01.2021

Ky projekt specifik i zbatuar kishte për qëllim lehtësimin e zhvillimit të planifikimit dhe menaxhimit të trashëgimisë në Kosovë në përputhje me normat dhe standardet Evropiane. Trashëgimia kulturore u përdor edhe si një mjet për inkurajimin e dialogut ndër- komunitar dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për mirëqenien e të gjitha komuniteteve.⁹⁶

Disa nga rezultatet më të spikatura që preknin edhe trashëgiminë kulturore të komunitetit serb ishin: 1. Hartimi i Planeve Rajonale të trashëgimisë për 5 rajonet e ndryshme të Kosovës, ku janë përfshirë të gjitha komunat, dhe 2. Organizimi i vizitave edukative në lokalitete të trashëgimisë kulturore ku kanë marrë pjesë me qindra nxënës, persona me aftësi të kufizuara dhe grupet e marginalizuara nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

3.6. Vizitat turistike në Manastirin e Deçanit, të Graçanicës dhe Patrikanën e Pejës (2011)

Pas luftës së vitit 1999 dhe trazirave të marsit të 2004-ës vizita e turistëve të huaj e në veçanti e banorëve lokalë shqiptarë në monumentet e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb ishte e vështirësuar dhe gati-gati e pamundur.

Në vitin 2011, pas periudhës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe me ndërrimin e strukturave në krye të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, dukej se po hapet një faqe e re në marrëdhëniet e bashkësisë fetare me institucionet dhe shoqërinë e Kosovës. Këtë faqe të re e hapi vizita e parë zyrtare e peshkopit të ri të Rashkës dhe të Prizrenit, Teodosije

së bashku me igumanin e Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq në komunën e Deçanit. "Tashmë kemi hyrë në një periudhë kur pavarësisht statusit, vërtet dëshirojmë të dëshmojmë se Kisha Ortodokse e Kosovës do të jetë një pjesë e mirë dhe konstruktive e kësaj shoqërie, me shpresën se rolin tonë do ta njohin edhe të tjerët, do na ndihmojnë dhe do na respektojnë" u shpreh igumani i Manastirit, Sava Janjiq.⁹⁷

Pas kësaj vizite dhe fillimin e ngritjes së mirëbesimit mes institucioneve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe, kishat e manastiret ortodokse filluan të jenë më të qasshme për vizitorë edhe pse ka ende hapësirë për përmirësim. Manastiri i Deçanit posedon edhe web- faqe ku mund të rezervohet vizita e turistëve, përfshirë këtu edhe orarin e vizitave. Web- faqja e manastirit në gjuhë serbe, nuk ka seksion të gjuhës shqipe (si gjuhë zyrtare të Kosovës) por ka seksion në gjuhë angleze, ruse, italiane, greke dhe franceze.⁹⁸ Manastiri i Graçanicës mund të vizitohet përmes rezervimit në zyrën turistike të Graçanicës përderisa edhe Patrikana e Pejës ka orar të vizitave të publikuar në hyrje dhe ofron edhe shërbime/paisje të audio-guidës në gjuhë të ndryshme të huaja përfshi edhe atë në gjuhë shqipe.

3.7. Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore në Partesh dhe investimet e bazuar në plan 2012-15

Një nga dispozitat e veçanta të Pakos së Ahtisarit, ishte edhe procesi i decentralizimit ku u themeluan edhe katër komuna të reja me shumicë serbe (Graçanica, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi). Parteshi ka qenë komuna e katërt që është themeluar përmes procesit të decentralizimit, më vonë sesa komunat e tjera, pasi që zgjedhjet lokale të vitit 2009 nuk mund të mbaheshin atje për shkak të rezistencës së komunitetit lokal serb. Fatmirësisht, zgjedhjet u mbajtën me 30 qershor të vitit 2010 dhe Kuvendi Komunal dhe qeveria lokale u themeluan në gusht të vitit 2010.⁹⁹

Edhe pse komunë shumë e vogël, Parteshi ka lokalitete të konsiderueshme të trashëgimisë kulturore dhe gjatë viteve 2012-15 ka përfituar nga programi i Planeve Lokale të Trashëgimisë Kulturore, i cili është inicuar nga CHwB Kosova dhe përkrahej financiarisht nga SIDA. Në projektet e realizuara në kuadër të këtij Plani që arrijnë vlerën mbi 100.000 Euro vlen të theksohet që 20% është mbuluar nga buxheti i Komunës së Parteshit dhe 10% nga buxheti i MKRS-së. Në kuadër të këtij programi që zhvillohej paralelisht edhe në Komunën e Gjakovës, Gjilanit, Rahovecit, Vushtrrisë, Kaçanikut e Dragashit, Komuna e Parteshit përfitoi nga ngritja e kapaciteteve të stafit të vet lokal, me themelimin e Fo-

⁹⁶ Council of Europe, EU/CoE support to the promotion of cultural diversity in Kosovo, <https://www.coe.int/en/web/culture-and-heritage/kosovo>, qasur 26.01.2021.

⁹⁷ Beqiraj Ajete, Frymë e re në Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, në DW, 2011, <https://www.dw.com/sq/fryme%3AB-e-re-n%3AB-kish%3ABn-ortodokse-serbe-n%3AB-kosov%3AB/a-15231796>, qasur 27.01.2021.

⁹⁸ Monastery Visoki Decani, <https://www.decani.org/en/>, qasur 27.01.2021.

⁹⁹ Tahiri Besnik, "Decentralizimi një peshë e rëndë për ta realizuar", (Prishtinë: Friedrich-Ebert-Stiftung, 2011), <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09760.pdf>, qasur 27.01.2021.



Foto6: Mbështetja e SHKA-ve me fonde për blerje të veshjeve tradicionale

rumit Lokal të Trashëgimisë Kulturore, si trup koordinues dhe vendimmarrës dhe ngritjen e vetëdijes së komunitetit përmes aktiviteteve të ndryshme. Ky forum përbëhej nga përfaqësues nga vet Komuna, institucionet qendrore të Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të OJQ-ve ndërkombëtare dhe në projekte të veçanta edhe me përfaqësues të Kishës Ortodokse Serbe. Projektet e realizuara në kuadër të këtij programi janë paraqitur në vijim:¹⁰⁰

- Konservimi i kishës Krishti Shpëtimtar në Gllaviçicë dhe ndërtimi i Visitoriumit (Qendrës së vizitorëve);
- Intervenimi emergjent dhe restaurimi i shtëpisë së Trajko Rajçiq në Pasjan;

- Rregullimi i burimit të ujit shërues në Pasjan;
- Hulumtimi dhe konservimi i gurit të kapellës së vjetër në Partesh;
- Rregullimi i kroit të fshatit në Partesh;
- Organizimi i ekskursioneve shkollore dhe vizitave në vende të tjera me trashëgimi kulturore në Kosovë, shkëmbimi i përvojave mbi ruajtje të trashëgimisë kulturore;
- Promo-video për trashëgimi kulturore dhe natyrore të komunës së Parteshit;
- Festivali: Glaviçica Etno Fest¹⁰¹;
- Mbështetja e SHKA-ve me fonde për blerje të veshjeve tradicionale;

¹⁰⁰ Toska Enes & Nora Arapi Krasniqi, Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore Partesh, (Prishtinë: CHwB Kosova, 2015).

¹⁰¹ Ky projekt u shndërrua në aktivitet tradicional dhe në vitet në vijim u organizua nga vet Komuna e Parteshit dhe është përkrahur financiarisht nga USAID në vitin e dytë, përderisa edhe sot vazhdon financimin nga vet Komuna.



3.8. Restaurimi i Kishës së Shën Nikollës në Bogoshevc, Prizren (2012)

International Relief and Development (IRD) në vitin 2012 përfundoi restaurimin e Kishës së Shën Nikollës në Bogoshevc të Prizrenit. Në inaugurimin e kishës së restauruar historike, morrën pjesë Atifete Jahjaga - Presidente e Republikës së Kosovës; Tracey Ann Jacobson - Ambasadore e SH.B.A.-së në Republikën e Kosovës; dhe udhëheqës të tjerë qeveritarë dhe fetarë.

Kisha e Shën Nikollës u ndërtua në fund të shek. XVI dhe fillimin e shek. XVII. Ajo ka një planimetri katrore drejt-këndëshe dhe është e harkuar me tytë me një absidë me pamje nga lindja. Muralet e saj të bukura datojnë nga kjo periudhë. Kisha ka pasur status të mbrojtjes që nga viti 1956¹⁰² dhe gjithashtu është Zonë e Veçantë e Mbrojtur.



Foto 7: Kisha e Shën Nikollës para dhe pas restaurimit

3.9. Këshilli i Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit dhe fshatit Hoçë e Madhe në Rahovec (2013)

Pas aprovimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, janë hartuar edhe ligjet e veçanta për Qendrën Historike të Prizrenit dhe atë për fshatin Hoçë e Madhe të Komunës së Rahovecit. Në bazë të dispozitave të këtyre ligjeve është parashikuar të themelohen edhe Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit¹⁰³ dhe Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe.¹⁰⁴

Më 2 korrik 2013, Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit është themeluar me përbërje të shtatëve anëtarëve që përfaqësojnë liderët e tri bashkësive kryesore fetare, gjegjësisht Kishës Ortodokse, Bashkësisë Islame dhe komunitetit katolik, si dhe tre përfaqësues të shoqërisë civile dhe një përfaqësues i pushtetit lokal. Këshilli ofron një forum për aktorët relevantë për të ndarë informata në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Qendrën Historike të Prizrenit.¹⁰⁵ Krahas institucioneve tjera lokale e qendrore në Prizren, ky Këshill është organ avokues për trashëgiminë kulturore dhe ka krijuar bashkëpunim të mirë edhe me aktorët tjerë relevantë përfshirë këtu edhe raportimin ndaj Kuvendit Komunal të Prizrenit. Përfaqësimi i komuniteteve fetare është i mirë, i balancuar dhe në funksion të misionit të vet këshillit.

Këshilli për Trashëgimi Kulturore të fshatit Hoçë e Madhe themelohet nga Kuvendi Komunal i Komunës së Rahovecit, dhe përfaqëson interesat e fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore në fushën e planifikimit rural.¹⁰⁶ Këshilli përbëhet nga pesë anëtarë, ku dy anëtarë zgjedhen nga Kuvendi i komunës, dy anëtarë zgjedhen drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit dhe një anëtarë nga Kisha Ortodokse Serbe; Mandati i parë i Këshillit është zgjedhur në vitin 2015. Mandati kryesor i këshillit është ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare të fshatit, si dhe ushtrim i përgjegjësisë në fushën e planifikimit hapësinor, që ndërlihet me zhvillimin e fshatit. Këshilli raporton në baza vjetore para anëtarëve të Kuvendit Komunal të Rahovecit.

¹⁰² IRD, Press Release: Completes Restoration of Historic Kosovo Church, 2012, <https://www.scribd.com/document/112452679/11-05-12-IRD-Completes-Restoration-of-Historic-Kosovo-Church>, qasur 27.01.2021.

¹⁰³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 14, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3303>, qasur 20.01.2021.

¹⁰⁴ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, neni 4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2835>, qasur 20.01.2021.

¹⁰⁵ OSCE, Challenges in the Protection of Immovable Tangible Cultural Heritage in Kosovo, (Prishtinë, 2014), f. 12, <https://www.osce.org/kosovo/117276>, qasur 20.01.2021.

¹⁰⁶ MMPH, Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 11/2014 Për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksionimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10264>, qasur 27.01.2021.

3.10. Programi i BE-së “Kosova e bukur” (2011-16)

Programi BE-së “Kosova e bukur (European Union – Beautiful Kosovo EU-BK)” ishte një program i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Misioni i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në Kosovë. Programi synonte të kontribuonte në uljen e varfërisë përmes rritjes së mundësive ekonomike për popullatën e Kosovës, veçanërisht grupeve të marginalizuara, në përputhje me Strategjitë Kombëtare. Faza e parë e programit, “EU-Beautiful Kosovo I” u zbatua nga Shkurt 2011 deri në Dhjetor 2013, përderisa faza e dytë, “EU-Beautiful Kosovo II”, u iniciua në fillim të vitit 2014 dhe u realizua me sukses deri në Shtator 2016.¹⁰⁷

Ky program kishte koordinim me institucionet e Kosovës dhe rezultoi me një numër të madh të investimeve në shumë komuna të Kosovës dhe atë në projekte infrastrukturore, ndërtesa publike, shkolla, fusha sporti dhe të tjera.

Në mesin e shumë projekteve në nivel vendi, përfituese të këtij programi ishin edhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb, sikurse:

- Restaurimi i kishës Shën së Shën Premtes në fshatin Llapje Sellë, Graçanicë - Totali i investimit: 98,425 Euro;
- Ndërtimi i Shtëpisë së Famullisë në fshatin Dobrothin, Graçanicë - Totali i investimit: 138,696 Euro (131,419 Euro kontribut i BE-KB dhe 7,277 Euro kontribut komunal);
- Ndërtimi i rrethojës tek manastiri i Arkangjejve të Shenjtë në Prizren - Totali i investimit: 9,063 Euro (Kontribut i BE-KB);
- Rindërtimi i kulmit të kishës së Shën Stefanit në Manastirin e Banjskës në Zveçan - Totali i investimit: 46,421 Euro (Kontribut i BE-KB);
- Ndërtimi i shtëpisë për mysafir dhe renovimi i oborrit në Manastirin e Dragancit në Novobërdë - Totali i investimit: 186,787 Euro (177,579 euro kontribut i EU-BK II si dhe 9,208 euro kontribut komunal);
- Ndërtimi i shkallëve dhe sheshit në luginën e Gradinës në Zubin Potok - Totali i investimit: 184.742 Euro (Kontribut i EU-BK II);
- Krijimi i shtigjeve për këmbësorë drejt kështjellës së Zveçanit - Totali i investimit: 105.412 Euro (103,281 euro si kontributi i EU-BK II dhe 2,131 eurosh si kontribut Komunal);




Foto 8: Restaurimi i kishës Shën Petka në Graçanicë (Burimi: BE)

¹⁰⁷ IOM, “EU-Beautiful Kosovo I Catalogue (in EN, ALB, SRB), EU-Beautiful Kosovo II Catalogue (in EN, ALB, SRB), <https://kosovo.iom.int/eu-beautiful-kosovo>, qasur 27.01.2021.



Foto 9: Konferenca ndërkombëtare e ndërfetare e vitit 2015

3.11. Promovimi i paqes dhe dialogut ndërfetar në Kosovë (2013-16)

Institucionet e Kosovës në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm ndërkombëtar dhe liderë fetar lokal e ndërkombëtar disa vite me radhë kanë promovuar dialogun ndërfetar si vlerë përmes konferencave të ndryshme ndërkombëtare.

Organizuar nga Misioni i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) në Kosovë

në 2013, konferenca mbi dialogun ndërfetar filloi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga komunitetet myslimane, ortodokse serbe, katolike, protestante dhe hebraike në Kosova. Udhëheqësit fetarë diskutuan mbi mbrojtjen e trashëgimisë fetare, të drejtat e pronës dhe kornizat ligjore për lirinë e fesë.¹⁰⁸

Në vitin 2015, Konferenca e 4-të Ndërkombëtare Ndërfetare e Kosovës në Prishtinë vendosi arritje të reja për shtrirjen globale përmes mediave sociale, pjesëmarrjes së të rinjve, barazisë gjinore dhe diversitetit. Me titull "Dialog ndërfetar në kohën e mediave sociale: Mundësimi i Agjentëve të Ndryshimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Gjuhës së Urrejtjes", ngjarja tre ditore u përqendrua në diskutimin e temave përmes një qasjeje multi-disiplinore dhe zhvillimin e mjeteve për të

përmirësuar aktivizmin shoqëror kundër ekstremizmit fetar. Delegatët përfshinin udhëheqës globalë të besimit, ministra dhe zyrtarë të lartë të qeverisë, sipërmarrës, përfaqësues ndërkombëtarë dhe anëtarë të shoqërisë civile.

Fjalët e hapjes nga Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, u pasuan nga një fjalim kryesor frymëzues, i mirëpritur nga Rabin Michael Melchior, Krye Rabin i Norvegjisë. Udhëheqësit e besimit të Kosovës gjithashtu iu drejtuan audiencës, ata përfshinin z. Ejup Ramadani nga Bashkësia Islame e Kosovës; Dr. Don Lush Gjergji nga Kisha Katolike e Kosovës; At Sava Janjiç, Kisha Ortodokse; Pastori Driton Krasniqi, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës; Sheh Lulzim Shehu, Unioni Sufi i Tariatëve të Kosovës; Z. Votim Demiri, Komuniteti Hebre i Kosovës; Baba Mumin Lama, Komuniteti Bektashi i Kosovës.¹⁰⁹

Më 18-19 Mars 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Europa Nostra Sneška Quaedvlieg-Mihailović vizitoi Kosovën dhe foli në Konferencën Ndërkombëtare Ndërfetare të mbajtur në qytetin historik të Prizrenit, e cila u organizua të përkonte me vizitën e Lartmadhërisë së Tij Princit Charles të Uellsit në vend, si pjesë e Turneut Mbretëror në Ballkan Perëndimor. Kjo konferencë u përqendrua në rëndësinë e trashëgimisë kulturore si një mjet për rigjenerimin ekonomik dhe shoqëror. Sekretarja e Përgjithshme e Europa Nostra-s ishte midis panelistëve në sesionin e ndjekur nga Princi.¹¹⁰

108 Religious communities in Kosovo meet for interfaith dialogue, 2013, <https://www.aa.com.tr/en/politics/religious-communities-in-kosovo-meet-for-interfaith-dialogue/218000>, qasur 28.01.2021.

109 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, https://mfa-ks.net/al/politika_single/3263, qasur 28.01.2021.

110 Europa Nostra, HRH the Prince of Wales and Europa Nostra's Secretary General promote heritage protection in Kosovo, 2016, <https://www.europanos->



Foto 10: Pritja zyrtare e Princit Charles dhe Dukeshës së Cornwallit në Kosovë dhe konferenca ndërkombëtare (Burimi: Telegrafi dhe Europa Nostra)



3.12. Programet e UNDP për mbrojtje dhe rehabilitim të trashëgimisë kulturore (2016-20)

Projekti i Ndërtimit të Besimit përmes Mbrojtjes Kulturore në Kosovë (CBCPK) synonte forcimin e besimit ndër-komunitar dhe respektin për identitetin kulturor dhe trashëgiminë kulturore. Aktivitetet në kuadër të projektit janë zbatuar përmes angazhimit të gjitha komuniteteve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pasur dhe të larmishme të Kosovës. Duke punuar ngushtë me zyrtarët komunalë dhe komunitetet fetare, ky projekt i financuar nga BE-ja është përqendruar në rinovimin, përmirësimin dhe rehabilitimin e vendeve të zgjedhura dhe krijimin e mekanizmave për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore. Projekti gjithashtu ka pasur një komponent të fortë të angazhimit të të rinjve dhe synonte të rrisë ndërgjegjësimin rreth diversitetit kulturor dhe përgjegjësinë e përbashkët për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in, projekti gjithashtu ka mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të Njësisë së Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare.¹¹¹

Në kuadër të këtij programi janë kryer aktivitete dhe investime të ndryshme në lokalitete të trashëgimisë në nivel vendi, përderisa janë arritur këto rezultate specifike për trashëgiminë kulturore të komunitetit serb në Kosovë:

- Kisha Ortodokse Serbe e Shën Nikollës - Rregullimi i oborrit (Kamenicë) - Totali i investimit: 30,576.12 Euro;

- Renovimi i Kapelës së Varrezave Ortodokse Serbe (Lipjan) - Totali i investimit: 36,517.75 Euro;
- Rinovimi dhe rindërtimi i gardhit tek Kisha Ortodokse Serbe Shën Flora dhe Laura (Lipjan) - Totali i investimit: 57,300.50 Euro;
- Rehabilitimi dhe ruajtja e Varrezave Multietnike të Qytetit (Gjilan) - Totali i investimit: 135,374.24 Euro;
- Rindërtimi i kabanës në Kishën Ortodokse Serbe (Ferizaj) - Totali i investimit: 27,056.50 Euro;
- Renovimi dhe rehabilitimi i Kishës së Shën Nikollës (Gjilan) - Totali i investimit: 97,476.94 Euro;
- Renovimi i Xhamisë së Sokolit dhe rregullimi i oborrit të Kishës së Shën Mërisë (Rahovec) (Trashëgimi Kulturore e Listuar) - Xhamia me kishën janë listuar si një projekt në vetë në projekt dhe shkaku i financimit të përbashkët nuk janë ndarë. Totali i investimit: 48,695.00 Euro;
- Instalimi i CCTV kamerave vëzhguese në Kishën Ortodokse Serbe të Ferizajit dhe në Patriarkanën e Pejës. - Totali i investimit: 71,446.00 Euro;




Foto 11: Kisha e Shën Arkangjelit me urën e re (Burimi: UNDP)

[tra.org/hrh-prince-wales-europa-nostras-secretary-general-promote-heritage-protection-kosovo/](https://hrh-prince-wales-europa-nostras-secretary-general-promote-heritage-protection-kosovo/), qasur 28.01.2021.

111 UNDP Kosovo, Confidence Building through Cultural Protection in Kosovo, 2020, https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/confidence-building-through-cultural-protection-in-kosovo.html, qasur 28.01.2021.



UNDP ka zbatuar edhe projektin "Dialogu Ndër-Komunitar përmes Ruajtjes Gjithëpërfshirëse të Trashëgimisë Kulturore" nga vitet 2018 deri më 2020, si fazë e dytë e projektit të mësipërm. Në mesin e rezultateve me përfitime të drejtpërdrejta të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe, mund të potencojmë:

- Adaptimin / zhvendosjen e urës dhe zgjerimi i rrugës hyrëse për në manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren¹¹²
- Restaurimin / rehabilitimin ekishës së Shën Nikolla Tutitit në Prizren¹¹³, dhe
- Pajisjen e 6 lokaliteteve me CCTV kamera për mbrojtje më të mirë të lokacionit.¹¹⁴

3.13. Ngritja e kapaciteteve të guidave turistike me etni të ndryshme (2019)

Organizata Turistike e Graçanicës (TOG) përmes grantit të UNDP në Kosovë në vitin 2019 ka synuar ruajtjen e trashëgiminë kulturore përmes zhvillimit të turizmit vendor. Organizata ka zhvilluar kritere trajnimi duke përfshirë

dy ekspertë me etni të ndryshe (Prof.Dr. Branko Krasojević dhe Prof. Zekë Çeku) për të organizuar trajnime, udhëhequr analiza praktike në terren duke prodhuar edhe një Manual për Guidat Turistike. Projekti trajnoi 27 pjesëmarrës me prejardhje dhe vendndodhje të ndryshme etnike (16 serbë, 11 shqiptarë dhe 1 turk) në një kurs trajnimi intensiv për guidat turistike. Pas trajnimit, pesë mikro- grante u janë dhënë pesë pjesëmarrësve të cilët zhvilluan ide inovatore dhe të denjë për të zhvilluar turizmin lokal. Projekti i TOG-ut „Zhvillimi i aftësive për guidat turistike në Kosovë” është pjesë e grantit të financiar nga projekti „Dialogu ndërmjet komuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë Kulturore” i zbatuar nga UNDP në Kosovë dhe implementuar nga Instrumenti i Bashkimit Evropian që kontribuon për Paqe dhe Stabilitet (IcSP).¹¹⁵

Për më tepër, organizata GUIDEKS (Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës) pas vendosjes së kontakteve me Organizatën Turistike të Graçanicës ka ftuar që edhe guidat turistike nga ky trajnim të kyqen në këtë organizatë. Sot GUIDEKS ka mbi 70 anëtarë anëmbanë Kosovës, me mision mbrojtjen dhe promovimin e profesionit të guidave turistike të vendit dhe në gjirin e saj ka anëtarë edhe të komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera.¹¹⁶




Foto 12: Në kuadër të këtij projekti është prodhuar edhe Manuali për Guida Turistike në tri gjuhë: Shqip, Serbisht dhe Anglisht

¹¹² UNDP Kosovo, Cultural Heritage in Kosovo – before and after, 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=lw1kd2KoYU4>, qasur 28.01.2021.

¹¹³ Ibid

¹¹⁴ Bugnion de Moreta Christian, Final External Evaluation of the "Inter-Community Dialogue through Inclusive Cultural Heritage Preservation", (UNDP, 2020), <https://erc.undp.org/evaluation/evaluations/detail/12363>, qasur 28.01.2021.

¹¹⁵ UNDP Kosovo, NGOs embark on promoting Dialogue through Cultural Heritage, 2018, <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/presscenter/articles/2018/12/19/ngos-embark-on-promoting-dialogue-through-cultural-heritage.html>, qasur 28.01.2021.

¹¹⁶ <https://guideks.org>, qasur 28.01.2021.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, gjegjësisht ministria Vlora Dumoshi, në fund të vitit 2020 ka nënshkruar vendimin për miratimin e Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit (PMQHP). Ky Plan është rezultat i përpjekjeve shumë vjeçare të institucioneve dhe shoqërisë civile të Prizrenit për mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrës historike të qytetit.

Element shumë i rëndësishëm i këtij plani është qasja gjithëpërfshirëse gjatë procesit të hartimit të punuar gjatë viteve 2017-19. Projekti, përmes formave të ndryshme të komunikimit si takime joformale, takime zyrtare, takime konsultative me grupe të ndryshme të shoqërisë, punëtori, ka konsultuar deri mbi 100 palë të interesit me të drejtat, detyrimet dhe interes në fushat e mbrojtjes, ruajtjes, promovimit dhe shfrytëzimit socio-ekonomik të Qendrës Historike të qytetit.¹¹⁸ Pjesë e palëve të interesit të përfshirë në proces ka qenë edhe përfaqësuesja e Kishës Ortodokse Serbe, anëtare e Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të QHP-së.



Foto 13: Ballina e Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit (Burimi: EC Ma Ndryshe)

118 <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40669>, gasur 28.01.2021.

3.15. Promovimi i turizmit të Kosovës në relacion me trashëgiminë ortodokse (2020)

Ekziston një konsensus tek ekspertët e sektorit dhe politikë-bërësit në Kosovë që përderisa turizmi nuk konsiderohet si fushë prioritare, zhvillimi i sektorit dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike të Kosovës do të vazhdojë të jetë i kufizuar. Turizmi qeveriset nga një ligj i nivelit qendror, por të cilit i mungon strategjia për zhvillim. Në të njëjtën kohë, përgjegjësia për sektorin është vënë nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe menaxhohet nga vetëm tre zyrtarë të cilët edhe përbëjnë Divizionin e Turizmit.¹¹⁹

Turizmi ofron potencial të mirë për të përfshirë minoritetet serbe në intervenime. Operatorët turistik për turist të huaj do të inkurajohen që të përfshijnë rrugët e verës në Rahovec, Brezovicë dhe Zubin Potok, zonat me industri turizmi tashmë të zhvilluar dhe meny të atraksioneve dhe aktiviteteve. Dy monumente kryesore religjioze në regjionin perëndimor—Manastiri i Deçanit, dhe Patriarkana e Pejës—janë të kyçur në ofertat turistike por bashkëpunimi duhet të zgjerohet. Po ashtu, kontaktet janë vendosur me Outdoor In, operator turistik në Zubin Potok i cili tashmë ka disa produkte turizmi malor në Veri të Kosovës.¹²⁰

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) e cila vepron në kuadër të MTI-së në kuadër të publikimeve dhe videove promovuese të Kosovës ka përfshirë edhe monumentet e Kishës Ortodokse Serbe në kuadër të paketave turistike.¹²¹

Fatkeqësisht, edhe pse sektor jo i zhvilluar, prezantimi i lokaliteteve të komunitetit serb duke mos përjashtuar edhe lokalitetet tjera të Kosovës, qoftë nga institucionet zyrtare por edhe nga operatorët turistik, në shumë raste kanë gabime profesionale dhe në disa raste kontestohen edhe nga vet përfaqësuesit e KOS-it. Kjo reflekton gjendjen tipike të mos-komunikimit dhe mungesës së efikasitetit të punës së përbashkët mes palëve të interesit për një kauzë zhvillimore sikurse që është turizmi.

The Mosque and Church in Ferizaj

A rare sight, the Mosque of Mulla Veseli and the St. Uroš Orthodox Cathedral share the same yard in the center of Ferizaj. The mosque was built in 1894 and reconstructed in 1941, while the church was constructed in 1927. Neither was destroyed during the war in 1999, although the church did suffer damage during riots in 2004.



Foto 14: Pjesë nga publikimi "Kosovo, a diamond in the rough"

3.16. Rruga e kontestuar e Manastirit të Deçanit (2020)

Një nga temat më të përfolura gjatë vitit të fundit padyshim ishte ndërtimi i rrugës Deçan – Plavë (Mali i Zi), projekt ky i cili është iniciuar nga Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Deçanit. Ky projekt ngjalli shumë kundërshtime dhe debat publik në Kosovë, pasi që Komuna e Deçanit insistonte në ndërtimin e një rruge e cila fillimisht u kundërshtua nga Manastiri i Deçanit pasi që traseja e rrugës kalonte përmes Zonës së Mbrojtur të Manastirit të Deçanit.

Igumeni i manastirit të Deçanit, Sava Janjiç, i tha Zërit të Amerikës se ndërtimi i kësaj rruge bie ndesh me ligjin e Kosovës për Zonat e Posaçme të Mbrojtura: "Ideja është të ndërtohet një autostradë praktikisht që çon nga Deçani në Plavë, që është rrugë ndërkombëtare dhe rrugë transiti. Sipas ligjit në zona të veçanta të mbrojtura rrugë të tilla janë të ndaluara për shkak të pasojave në mjedis, zhurma, trafiku i rënduar, ndotja dhe të tjera. Në vitin 2014 qeveria e atëhershme e Kosovës e gjeti një zgjidhje për të ndërtuar një bypas që do të kalonte nga ana tjetër e malit përgjatë zonës së mbrojtur dhe pastaj do të bashkohej me rrugën në pikën ku përfundon zona e mbrojtur. Kjo ishte një zgjidhje e pranueshme edhe për komunitetin ndërkombëtar edhe për ne". Ai thotë se punimet bien ndesh edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që i njohu manastirit pronësinë mbi

119 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Profili i sektorit të turizmit", 2014, <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/86E95F79-EEF6-4B2B-B1CC-A0317678A3AD.pdf>, qasur 28.01.2021.

120 PPSE Promoting Private Sector Employment, "Turizmi në Kosovën Perëndimore - Raporti mbi Strategjinë e Tregut", 2015.

121 Publikimet: "Kosovo, a diamond in the rough", "Kosovo Toursit Map" dhe videoja promovuese "Kosovo Ready For You to Visit", <https://www.youtube.com/watch?v=3X-SBC2IryE>, qasur 28.01.2021.



Foto 15: Takimi i Këshillit për Zbatim dhe Monitorim më 9 Nëntor 2020

rreth 22 hektarë tokë përreth, një vendim që sipas zotit Ramosaj (kryetar i Komunsë së Deçanit) është politik dhe cenon interesat e banorëve të Deçanit¹²².

Një nga reagimet e para të kryeministrit të Kosovës, Abdullah Hoti për këtë projekt të kontestuar ishte ajo në Facebook, duke deklaruar: "Pa u ndikuar nga zhurmat nëpër studio televizive, ne do ta ndërtojmë rrugën Deçan-Plavë në bashkëpunim të ngushtë me Deçanin dhe të gjitha institucionet e tjera kompetente, duke respektuar ligjet e shtetit të Kosovës. Zhurma nuk është zgjidhje për shqetësimet e qytetarëve tanë, por puna, angazhimi dhe respektimi i normave ligjore dhe kushtetuese".¹²³

Krahas Manastirit të Deçanit edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë ka reaguar duke lëshuar një deklaratë të përbashkët të vendeve të Quint-it lidhur me punimet që po bëhen në zonën e Manastirit të Deçanit. "Të enjten, më 27 gusht 2020, ambasadorët e Francës, Gjermanisë, Italisë, Anglisë dhe SHBA-së, së bashku me përfaqësues nga BE, KFOR dhe OSBE vizituan rajonin e Deçanit, në një udhëtim për gjetje të fakteve. Ata u takuan veçmas me kryetarin Bashkim Ramosaj dhe atin e Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq. Ne u bëjmë thirrje palëve që të zbatojnë me përpikëri ligjet e Kosovës, në veçanti ligjin e vitit 2008 për

Zonat e Veçanta të Mbrojtura, dhe çdo shqetësim ta adresojnë brenda kornizës së Këshillit monitorues të implementimit (KPM), para se të marrin ndonjë veprim. Për më tepër, ne nxisim autoritetet e Kosovës që të zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 19 majit 2016 për çështjen e mosmarrëveshjes lidhur me tokën në Deçan. Për fund kërkojmë që Qeveria e Kosovës të zgjidhë në mënyrë të shpejtë çështjen e punimeve në rrugë në përputhje me atë që u tha më sipër," thuhet në deklaratë.¹²⁴

Pas një periudhe intensive negociatash e takimesh, më 12 Nëntor 2020 arrihet marrëveshja për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e rrugëve të cilat kalojnë nëpër Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit. Kështu është bërë e ditur përmes një komunikate për media të Zyrës së Kryeministrit, marrëveshje e cila thonë se u arrit me ndërmjetësimin e Kryeministrit Avdullah Hoti dhe me mbështetjen e Ambasadorit të Italisë, Nicola Orlando e të Komandantit të KFOR-it, Gjeneral Michele Risi.

Sipas njoftimit, kjo marrëveshje është rezultat i diskutimeve disa mujore, por konstruktive dhe frytdhënëse, midis Komunës së Deçanit dhe përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në Manastirin e Deçanit. "Mekanizimi i përhershëm i implementimit dhe mbikëqyrjes (Këshilli i Imple-

¹²² <https://kallxo.com/lajm/sava-janjiq-ndertimi-i-rruges-ne-decan-bie-ndesh-me-ligjin-per-zonat-e-posacme-e-te-mbrojtura/>, qasur 28.01.2021.

¹²³ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-nuk-zbrapset-nga-vendimi-per-ndalimin-e-punimeve-decan-plave/>, qasur 28.01.2021.

¹²⁴ <https://kallxo.com/lajm/vendet-e-quint-it-dalin-me-deklarate-te-perbashket-lidhur-me-punimet-ne-zonen-e-manastirit-te-decanit/>, qasur 28.01.2021.

mentimit dhe Mbikëqyrjes) mbështetur në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (nr. 03/L-039) ka miratuar termet e kësaj Marrëveshjeje dhe kështu i është dhënë drita e gjelbër veprimeve të dakorduara për implementim. Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, ka qenë i përkushtuar qysh në fillim që të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjes së mirë dhe të pranueshme, e cila ndihmon lëvizjen e lirë të qytetarëve, si liri e garantuar, por edhe të respektojë dhe të mbrojë trashëgiminë religjioze dhe kulturore të asaj zone”, thuhet në kumtesë.

Ndërkaq, Zyra e BE-së në Kosovë njoftoi se më 9 nëntor u zhvillua takimi i Këshillit për Zbatim dhe Monitorim (KZM), nga e cila u miratua një aranzhim për rehabilitimin e rrugëve në komunën e Deçanit. “KZM miratoi një aranzhim për rehabilitimin e rrugëve në komunën e Deçanit duke e respektuar Ligjin përkatës të Kosovës nr. 03 / L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM) të datës 15 qershor 2008. Aranzhimi përfshin zhvillimin sinkron/të njëkohshëm të dy rrugëve, asaj ndërkombëtare të bajpasit jashtë kufijve të ZVM dhe të një rruge lokale brenda ZVM. Me këtë synohet nxitja e marrëdhënieve ndër- komunitare përmes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore fetare dhe forcimi i zhvillimit ekonomik brenda komunës së Deçanit dhe rajonit”, thuhet në njoftim.¹²⁵

Krahas temës së ndërtimit të rrugës, e cila u trajtua më sipër, një problematikë që ende nuk është zgjidhur ka të bëjë me kontekstin pronësor në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila ia jep të drejtën pronësore Manastirit të Deçanit, vendim ky i cili ende nuk është zbatuar nga Komuna e Deçanit. Reagime ndaj mos- zbatimit të këtij vendimi janë dhënë nga përfaqësues të Misionit të BE-së në Kosovë, Ambasada e SHBA-së dhe bashkësia ndërkombëtare. Në deklaratën e dhënë nga Ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka kërkuar që institucionet e Kosovës të zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për tokën e Manastirit të Deçanit.¹²⁶ “Katër vjet janë shumë të gjata. Respektimi i vendimeve gjyqësore nuk është opcional, por i detyrueshëm. Institucionet duhet të zbatojnë vendimin për tokën e Manastirit të Deçanit menjëherë”, ka shkruar Kosnett.

Duke aluduar në bazën ligjore të mirë në Kosovë, ky fakt e ilustron mangësinë e zbatimit të ligjeve dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pronat e Manastirit të Deçanit që nuk është zbatuar që pesë vite.

3.17. Manastiri i Deçanit, në listën preliminare të 12 aseteve të trashëgimisë Evropiane më të rrezikuara për vitin 2021 (2020)

Europa Nostra është një federatë Pan-Evropiane për Trashëgiminë Kulturore, që përfaqëson organizatat e qytetarëve që punojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Evropës. Kjo organizatë është zëri i kësaj lëvizjeje për organet përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës dhe UNESCO-n. Për mbi 50 vjet, kjo organizatë njihet si organizata më përfaqësuese e trashëgimisë në Evropë me anëtarë nga mbi 40 vende të ndryshme. Në fund të vitit 2020, Europa Nostra e ka futur Manastirin e Deçanit në programin e 12 aseteve më të rrezikuara të trashëgimisë evropiane për vitin 2021. Ajo ka shpallur listën preliminare për 12 vendet e trashëgimisë evropiane të përzgjedhura për programin “7 më të rrezikuara 2021” pjesë së cilit program është edhe Manastiri i Deçanit.¹²⁷ Europa Nostra, përveç përshkrimit që i bën Manastirit dhe ambient që e rrethon, si dhe faktit se që nga pas lufta ruhet nga KFOR-i gjatë 24 orëve në ditë, potencon se Manastiri i Deçanit nuk i ka shpëtuar sulmeve, siç thotë në komunikatën e saj ky institucion, të ekstremistëve lokal, duke i lidhur edhe me ISIS-in. “Që nga qershori i vitit 1999, Manastiri i Deçanit ka qenë nën mbrojtjen 24/7 nga trupat paqeruajtëse KFOR të udhëhequra nga NATO. Përkundër kësaj, manastiri ishte një shënjestër e katër sulmeve me granata mortaje nga ekstremistët lokalë gjatë periudhës nga 1999 në 2007, si dhe një sulmi terrorist në tentativë nga ISIS në 2016, duke shkaktuar një dëm lehtësisht të riparueshëm. Në të njëjtën kohë, manastiri me zonën e tij të veçantë mbrojtëse po përballet me kërcënime serioze mjedisore. Plani hapësinor komunal lokal nuk është në përputhje me rregullat e rrepta të mbrojtjes për një Trashëgimi Botërore të UNESCO-s ose ligjet dhe rregulloret përkatëse kombëtare. Ekziston një rrezik i vazhdueshëm i ndërtimit të objekteve të papërshtatshme urbane në afërsi të manastirit, si dhe rreziku i shpronësimit të tokës që i përket Manastirit të Deçanit. Veçanërisht i rrezikshëm është plani për të patur një autostradë të madhe ndërkombëtare pranë portave të manastirit”, thuhet në komunikatën e “Europa Nostra”¹²⁸.

Edhe pse kontesti i ndërtimit të rrugës Deçan-Plavë tanimë ka marrë epilog (shih shembullin e mësipërm), me sa duhet

125 <https://kallxo.com/lajm/arrihet-marreveshja-per-perdorimin-e-rrugeve-qe-kalojne-prane-manastirit-te-decanit/>, qasur 28.01.2021.

126 <https://kallxo.com/lajm/kosnett-kerkon-qe-menjehere-te-zbatohet-vendimi-i-kushtetueses-per-manastirin-e-decanit/>, qasur 29.01.2021.

127 Europa Nostra, Decani Monastery, Kosovo* - 7 Most Endangered, <http://7mostendangered.eu/sites/decani-monastery-kosovo/>, qasur 21.01.2021.

128 Ibid.

The 7 Most Endangered Programme

A civil society campaign to save Europe's heritage in danger

Photo: The European Heritage Label and the European Heritage Convention 2021

PRESS RELEASE 2021 SHORTLIST

3.18. Rekapitullim

Është fakt i pamohueshëm që shumica e projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë janë bërë me ndihmën financiare të partnerëve strategjikë e organizatave ndërkombëtare pasi që projektet e kësaj natyre kanë kosto të lartë për një shtet ku buxheti publik nuk mjafton për trajtim të nevojave të sektorit. Këtu mund të themi që pronat e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb kanë përfituar shuma të konsiderueshme të përkrahjes në raport me lokalitetet tjera në Kosovë. Vlen për tu theksuar se këto projekte të financuara nga fondet ndërkombëtare kanë shërbyer edhe si platformë bashkëpunimi e komunikimi mes institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës, OJQ-ve vendore, komuniteteve fetare përfshi edhe ato të Kishës Ortodokse Serbe.

Tek rastet negative, sikurse pasojat e trazirave të Marsit 2004, vërehet kontributi financiar edhe i institucioneve të Kosovës sikurse tek vandalizimi apo vjedhjet e kishave ortodokse kemi gjithmonë deklarata dënuese të krerëve të shtetit të Kosovës përfshi edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë. Këtu vlen të përmenden edhe zhvillimi i kapaciteteve të Njësisë së Policisë së Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare.

4. EKSTERRITORIALITETI NË KONTEKST TË DIALOGUT TË NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE KOSOVË-SERBI

Edhe pse ky hulumtim nuk ka qëllim të trajtojë trashëgiminë kulturore në këndvështrim politik sepse konsiderohet që politika ka "kontribuar dhe abuzuar" mjaft në këtë temë, është e paevitueshme dhe e patejkalueshme të analizohet çështja e trashëgimisë kulturore pa përmendur edhe temën e "shumëpërfolur" të eksteritorialitetit të Kishës Ortodokse Serbe.

Aktorët politik në Kosovë e Serbi por edhe përfaqësues tjerë të dyja vendeve "jo zyrtarisht" parashikojnë që kjo temë mund të futet në agjendë të procesit të dialogut të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, dialog ky i iniciuar nga BE që nga viti 2011 dhe atë fillimisht si dialog në format teknik por tanimë të shndërruar në format politik.

4.1. Prapavija e procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe eksteritorialiteti

Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, Republika e Kosovës u bë shteti më i ri në Evropë. Kosova synon anëtarësimin në NATO, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në Bashkimin Evropian. Ajo sot njihet nga 117 shtete të ndryshme.^{129 130}

Qeveria e Serbisë nuk e njeh Kosovën si shtet sovran dhe ende e konteston një vendim të tillë. Në korrik të vitit 2010,

rasti i Qeverisë serbe para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) dështoi, kur shpalljen e pavarësisë së Kosovës të 17 Shkurtit të vitit 2008, vendimi nuk e deklaroi të jetë shkelje e ligjit ndërkombëtar.¹³¹

Pas dhënies së mendimit këshillëdhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) rreth aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, miratoi rezolutën e sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian dhe Serbia, e cila hapi rrugë për fillimin e dialogut Kosovë - Serbi, të lehtësuar nga BE. Kjo rezolutë, e miratuar me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përshëndeste mendimin e GJND-së, si dhe e mirëpriste gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se ky proces do të shërbente si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Ky proces u tha se do të promovojë bashkëpunimin, përmirësoj jetën e qytetarëve dhe do t'i ndihmoj të dyja vendet të arrijnë progres në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.

Si rrjedhojë, më 10 mars 2011, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë e cila e mandatonte Qeverinë e Republikës së Kosovës për të nisur bisedimet teknike me Serbinë, si dhe

¹²⁹ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Lista e Njohjeve, <https://www.mfa-ks.net/politika/484/lista-e-njohjeve/484>, qasur 02.02.2021.

¹³⁰ Që nga 4 shtatori 2020, 98 nga 193 (51%) shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara (KB), 22 nga 27 (81%) shtete anëtare të Bashkimit Evropian (BE), 26 nga 30 (87%) shtete anëtare të NATO-s, dhe 33 nga 57 (58%) vendet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (OIC) e kanë njohur Kosovën

¹³¹ INTERNATIONAL COURT OF JUSTICE: Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo, 22 July 2010 <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/16010.pdf>, qasur 26.01.2021.

i kërkonte asaj që të raportonte në baza të vazhdueshme për rrjedhën e procesit. Përmes kësaj rezolute, Kuvendi i Republikës së Kosovës gjithashtu e obligoi ekzekutivin që t'ia paraqiste dokumentin themelor për dialogun brenda afateve ligjore, duke specifikuar parimet e përgjithshme të dialogut teknik, objektivat si dhe çështjet e panegociueshme. Krahas bisedimeve teknike, në fund të vitit 2012 filluan edhe bisedimet politike për normalizim të marrëdhënieve. Me 18 tetor 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë të re përmes së cilës përkrahte fillimin e dialogut politik duke mandatuar sërish Qeverinë e Kosovës për të udhëhequr me këtë proces.

Dialogu me Serbinë është karakterizuar nga ndërprerje dhe vonesa të kohë pas kohëshme, si pasojë e tensioneve, qoftë të brendshme apo edhe ndërmjet dy vendeve. Në veçanti, zgjedhjet nacionale në të dy vendet gjatë vitit 2014, shkaktoan vonesa të mëdha në zhvillimin e dialogut. Së fundmi, dialogu ishte pezulluar me anë të një rezolute të Kuvendit të Kosovës në mars të vitit 2017, pas arrestimit të Ramush Haradinajt më 04 janar 2017 në Francë.

Deri më tani, janë arritur mbi 23 marrëveshje në nivelin teknik dhe politik. Shumica e këtyre marrëveshjeve kanë adresuar çështje me rëndësi për jetën e qytetarëve, të cilat kanë synuar shpërbërjen e strukturave paralele serbe në Kosovë, shtrirjen e shtetit ligjor në tërë territorin e vendit dhe konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Megjithatë, zbatimi i tyre nuk ka qenë i kënaqshëm duke u nisur dhe nga vet natyra e marrëveshjeve si dhe mosgatishmëria e palëve e veçanërisht e Serbisë për të respektuar marrëveshjet e arritura.¹³²

Procesi i dialogut është zhvilluar me kundërthënie të mëdha dhe polarizim të skenës politike. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies e kanë karakterizuar këtë proces që nga fillimi. Prandaj, së fundmi është artikuluar nevoja e një konsensusi të përgjithshëm politik mbi këtë çështje. Faza përfundimtare e dialogut pritet të kurorëzohet me arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme në mes palëve, ndërsa BE në strategjinë e fundit të Komisionit Evropian ka shprehur qartë se rruga drejt BE-së për të dy palët lidhet me këtë proces.¹³³

Takimet e palëve, në kuadër të procesit të dialogut të normalizimit të marrëdhënieve planifikohej të vazhdohej më 27 Qershor të vitit 2020 dhe atë nën udhëheqjen e SHBA-ve. Ky takim u anulua pas njoftimit për një aktakuzë për krime lufte ndaj presidentit të Kosovës Hashim Thaçi.¹³⁴ Pas disa muajve, më saktësisht më 4 shtator 2020, Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, në prani të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kanë nënshkruar marrëveshje për normalizim ekonomik në Shtëpinë e Bardhë (Washington, SHBA). Ata janë pajtuar të zbatojnë një sërë marrëveshjesh të arritura tashmë, siç është ajo për

autostradën mes Kosovës dhe Serbisë, ajo për hekurudhat dhe për linjën ajrore.¹³⁵ Pjesë e Marrëveshjes së Washingtonit ku përmendet trashëgimia kulturore thuhet se "Të dyja palët zotohen se do të mbrojnë dhe promovojnë liritë fetare, duke përfshirë edhe rifillimin e komunikimit ndërfetar, mbrojtjen e vendeve fetare dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, që janë të lidhura me Kishën Ortodokse Serbe..."¹³⁶

Në retrospektivë, në kuadër të procesit të dialogut, vitin 2019, hapja e temës së trashëgimisë kulturore apo edhe e eksterritorialitetit të kishave ortodokse serbe nuk përmendet. Kjo dëshmohej edhe nga dokument i presidenti Hashim Thaçi drejtuar delegacionit shtetëror të Kosovës.¹³⁷ Letra ku i referohej saktësisht kësaj teme thotë:

"Është kjo një temë që ka një interesim të veçantë nga ana e EEAS-it dhe natyrisht edhe nga Serbia. Përfaqësuesit e zonjës Mogherini, përkundër shpjegimeve tona për karakterin sekular të shtetit të Kosovës dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, insistojnë se do të ishte mirë që përmes amendamentimit të Kushtetutës së Kosovës (pas ratifikimit të marrëveshjes eventuale ligjërish të detyrues në mes të Kosovës dhe Serbisë) të bëhej garantimi i të drejtave dhe privilegjeve të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë; dhe që të specifikohet në Kushtetutë që selia e kësaj Kise është në Beograd. Ne kemi argumentuar se: garantitë e kërkuara mund të adresohen vetëm nëpërmjet ndryshimeve ligjore në ligjet relevante, të cilat mbulojnë këtë fushë. Sidoqoftë, sa i përket statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, në Zyrën e znj. Mogherini bindja

132 Kosovo Democratic Institute, "Analizë e shkurtër: Dialogu Kosovë – Serbi: sfidat dhe rruga përpara", (Prishtinë; 2018), f. 5.

133 Ibid.

134 <https://www.dw.com/sq/d%C3%ABshton-takimi-n%C3%AB-shba-kryeministri-hoti-anuloi-pjes%C3%ABmarrjen/a-53934884>, qasur më 26.01.2021

135 <https://www.evropaelire.org/a/linja-ajrore-izraeli-marreveshja-shtepia-e-bardhe/30820613.html>, qasur 26.01.2021.

136 <https://www.evropaelire.org/a/marreveshja-kosova-serbia-trump-vucic-hoti/30821572.html>, qasur 26.01.2021.

137 Dokument i përditësuar për Delegacionin Shtetëror të Republikës së Kosovës mbi fazën përfundimtare të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, Prishtinë, 21 janar 2019.

mbizotëruese është që Aneksi V i Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari dhe Korniza legale e Kosovës, që ka reflektuar këtë Propozim, është një bazë shumë e mirë/ adekuate ligjore për të akomoduar statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.”¹³⁸

Për temën e trashëgimisë kulturore dhe në veçanti për termin e ekstraterritorialitetit (si një koncept territorial), para takimit të Washingtonit, edhe kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti deklaroi se “... Integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i padiskutueshëm.

Marrëveshjet duhet të arrihen me njohje reciproke”¹³⁹.

Edhe pse përfaqësuesit politik të Kosovës zyrtarisht nuk e kanë pranuar që kjo temë do të hapet gjatë procesit, janë dy palë që hedhin dyshime në këtë pretendim:

Në një raport të Akademisë së Shkencave të Artit të Kosovës ku mes tjerash kritikohet Qeveria e Kosovës për mos përgatitje të mirë në proces të dialogut, thuhet se: “Madje, nuk ishte punuar asgjë e veçantë për tu përballur me planin rezervë serb katër pikësh, pjesë e propozuar e të cilit ishte regjioni autonom i katër komunave veriore me shumicë serbe dhe decentralizimi me kompetenca të zgjeruara të komunave me shumicë serbe në viset në jug të Kosovës, përfshirë ekstraterritorialitetin për monumentet dhe kishat ortodokse serbe.”¹⁴⁰

Ekstraterritorialiteti si koncept ishte ngritur edhe në të kaluarën nga përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile pas aprovimit të Ligjit për Zona të Veçanta duke e vlerësuar edhe si kërcënim për integritetin territorial të Kosovës.¹⁴¹ Edhe sot e kësaj dite shumë përfaqësues të shoqërisë civile pretendojnë që kjo temë do të hapet në proces të dialogut edhe pse niveli politik në Kosovë nuk e pranon një gjë të tillë.

4.2. Çka është ekstraterritorialiteti?

Ekstraterritorialiteti, i quajtur ndryshe edhe si ekstraterritorialitet, ose imunitet diplomatik, në të drejtën ndërkombëtare nënkupton imunitetet që gëzojnë shtetet e huaja ose organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e tyre zyrtarë nga juridiksioni i vendit në të cilin ata janë të pranishëm.¹⁴²

Ekstraterritorialiteti shtrihet në shtetet e huaja ose organizatat ndërkombëtare si subjekte dhe mbi kryetarët, zyrtarë, trupat në kalim, anijet e luftës, mjediset e misioneve të caktuara dhe pasuritë e tjera. Kjo i përjashton ata, përderisa janë brenda territorit të një sovranit të huaj, nga procesi gjyqësor vendor, ndërhyrja e policisë dhe masa të tjera shtrënguese. Termi buron nga trillimi që personat ose gjërat e tilla konsiderohen se nuk janë brenda territorit të sovranit ku ata janë aktualisht të pranishëm.¹⁴³

Fjala ekstraterritorialitet ose ekuivalenti i saj i huaj nuk ishte në përdorim deri në fund të shekullit të 18-të. Ai fitoi një vend në fjalorin ligjor përmes përdorimit të tij, nëse jo të krijimit, nga Georg Friedrich von Martens (1756–1821), traktati i të cilit mbi ligjin e kombeve, botuar në 1788, fitoi reputacion ndërkombëtar dhe u përkthye menjëherë në disa gjuhë, përfshirë anglishten.¹⁴⁴

Kombet e Bashkuara, si entitet legal, zyrtarët e saj si dhe anëtarët e delegacioneve të shteteve anëtare në Kombet e Bashkuara gëzojnë imunitete procedurale, fiskale dhe të tjera nga juridiksioni i vendeve ku ata janë të pranishëm. Në shumicën dërrmuese të kombeve anëtare, çështja rregullohet nga Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në 1946. Sidoqoftë, rregullime të veçanta aplikohen në Shtetet e Bashkuara dhe Zvicër sepse Shtetet e Bashkuara përfshijnë selinë e KB dhe Zvicra ka zyrat e KB në Gjenevë.¹⁴⁵

138 Faqe 6: Dokument i përditësuar për Delegacionin Shtetëror të Republikës së Kosovës mbi fazën përfundimtare të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, Prishtinë, 21 janar 2019.

139 <https://www.dw.com/sq/hoti-dialogun-me-serbin%C3%AB-do-ta-udh%C3%ABheq%C3%AB-kryeministri-territori-nuk-diskutohet/a-53771892?fbclid=IwAR0diYHNWM0ncRmsGA-adJ3ibGNv2W9vmc85fTTUN3Gwog6JyZb0A5wKtJE>, qasur 29.01.2021.

140 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, DIALOGU KOSOVË-SERBI Dilemat dhe kundërtëhëniet, (ASHAK: Prishtinë, 2020), f.12.

141 EC Ma Ndryshe, “GABIM PAS GABIMI Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore; Seria e analizave Çka shkoi ters?”, (EC Ma Ndryshe: Prishtina, 2013), f. 27-28.

142 Britannica, T. Editors of Encyclopaedia. “Extraterritoriality.” (Encyclopedia Britannica, 2017). <https://www.britannica.com/topic/extraterritoriality>, qasur 29.01.2021.

143 Ibid.

144 Ibid.

145 Ibid.

Në kundërshtim me besimin popullor, misionet diplomatike në përgjithësi nuk gëzojnë status të plotë ekstraterritorial dhe nuk janë territor sovran i shtetit të përfaqësuar.¹⁴⁶

Historikisht, fuqitë perandorake shpesh i detyronin shtetet e dobëta t'u jepnin të drejta jashtë-territoriale qytetarëve të tyre që nuk ishin diplomatë – përfshirë ushtarë, tregtarë, misionarë të krishterë dhe të ngjashëm me ta. Kjo ishte më e njohur në Azinë Lindore gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, ku Kina dhe Japonia nuk u kolonizuan zyrtarisht, por ishin nënshtruar në një farë mase fuqive perëndimore.¹⁴⁷

Sidoqoftë, tani këto të drejta më së shpeshti u jepen zyrtarëve të huaj vizitorë edhe madje memoriale (e busteve) dhe parcelave të tokës kushtuar agjencive të huaja siç janë varrezat e luftës me kombësi të dyfishtë dhe memoriale për personalitete të famshme të huaja.¹⁴⁸

4.3. Aplikimi i ekstraterritorialitetit në kontekst të trashëgimisë kulturore në botë

Lufta e Dytë Botërore i dha fund traktateve të pabarabarta. Pas vitit 1945, rendi botëror perandorak u shemb dhe ekstraterritorialiteti ra nga përdorimi jashtë qarqeve diplomatike. Sot, ambasadorët dhe stafi i tyre, zyrtarë dhe zyra të Kombeve të Bashkuara dhe anijet që lundrojnë në ujërat ndërkombëtare janë midis njerëzve ose hapësirave që mund të gëzojnë ekstraterritorialitet.

Në kohët moderne, në kundërshtim me traditën, kombet mund t'i shtrijnë këto të drejta tek aleatët që janë duke i vizituar dhe shpesh janë të punësuar gjatë lëvizjes tokësore të trupave ushtarake përmes territorit miqësor. Është inte-



Foto 17: Shteti qytet i Vatikanit (Autor: Jamie Davies)

146 Integrity Legal Blog, "Laws and Rules Regarding Extraterritoriality", (Integrity Legal, 2009), <http://integrity-legal.com/legal-blog/miscellaneous/laws-and-rules-regarding-extraterritoriality/>, qasur më 28 Janar 2021.

147 Szczepanski, Kallie, "What Is Extraterritoriality?", (ThoughtCo, 2020), [thoughtco.com/what-is-extraterritoriality-194996](https://www.thoughtco.com/what-is-extraterritoriality-194996).

148 Ibid

resante se shërbimet funerale dhe përkujtimet shpesh u janë dhënë të drejta ekstraterritoriale kombeve që nderojnë memorialin, parkun ose strukturën siç është rasti me memorialin e John F. Kennedy në Angli dhe varrezat (me kombësi të dyfishtë) si Varrezat Amerikane të Normandisë në Francë.¹⁴⁹

Sipas përkufizimeve zyrtare por dhe traditës, vërehet se, ekstraterritorialiteti në raste të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore aplikohet shumë rrallë dhe në raste shumë specifike. Më poshtë gjenden këto shembuj të paktë në vende (shtete) që kanë lëshuar një farë kontrolli mbi territorin e tyre dhe atë pa cenuar sovranitetin e tyre:

PRONAT EKSTERRITORIALE TË SELISË SË SHENJTË (SHTETI I VATIKANIT) NË ROMË (ITALI)

Qyteti i Vatikanit është shteti i pavarur i qytetit të Selisë së Shenjtë dhe enklavë brenda Romës (Itali). Shteti i Qytetit të Vatikanit, i njohur gjithashtu vetëm si Vatikani, u bë i pavarur nga Italia me Traktatin e Lateranit (1929), dhe është një territor i veçantë nën "pronësinë e plotë, sundimin ekskluziv dhe autoritetin dhe juridiksionin sovran" të Selisë së Shen-

ruan pavarësinë materiale, diplomatike dhe shpirtërore të qytetit shtet. Disa prona të Vatikanit (kisha etj), jashtë qytetit-shtet të Vatikanit në Romë gëzojnë të drejta ekstraterritoriale dhe janë në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.¹⁵⁰

KALAJA ST. ANGELO NË MALTË

Kalaja St. Angelo është një fortesë e bastionuar në Birgu, Maltë, e vendosur në qendër të Portit të Madh. Ajo u ndërtua në periudhën mesjetare si një kështjellë e quajtur Castrum Maris (shqip: Kala buzë detit). Kalaja u rindërtua nga Urdhri i Shën Gjoni si një fortifikatë e quajtur Fort Saint Angelo midis viteve 1530 dhe 1560 dhe u njoh më së shumti për rolin e saj si selia e Urdhrit gjatë

Rrethimit të Madh të Maltës të vitit 1565. Fortesa ishte pushtuar nga Britanikët për periudhë gati 200 vjeçare (nga 1800 deri në 1979). Fortesa pësoi dëme të konsiderueshme gjatë Luftës së Dytë Botërore, por më vonë u restaurua. Më 5 Dhjetor 1998, një traktat u nënshkrua midis Maltës dhe Urdhrit Sovran Usharak të Maltës që i jepte Urdhrit ekstraterritorialitet të kufizuar në pjesën e sipërme të Kalasë St Angelo, duke përfshirë Selinë e Mjeshtrit të Madh dhe Kapelën e Shën Anës.^{151 152}



itë vetë një entiteti sovran i së drejtës ndërkombëtare, i cili
Foto 18: Kalaja St. Angelo në Maltë (Autor: Frank Vincentz)

VARRI I SHAH SULEJMANIT NË SIRI

¹⁴⁹ Ibid.

¹⁵⁰ UNESCO, Vatican City and UNESCO Historic Centre of Rome, the Properties of the Holy See in that City Enjoying Extraterritorial Rights and San Paolo Fuori le Mura, <https://whc.unesco.org/en/list/91/>, <https://whc.unesco.org/en/list/286/>, qasur 29.01.2021.

¹⁵¹ https://en.wikipedia.org/wiki/Fort_St_Angelo, qasur 29.01.2021.

¹⁵² <https://web.archive.org/web/20131020195647/http://www.orderofmalta.int/news/39146/after-two-centuries-the-order-of-malta-flag-flies-over-fort->



Foto 19: Varri i Shah Sulejmanit (Autore: Céline Rayne)



Foto 20: Longwood House (Autor: Michel Dancoisne-Martineau)

Varri i Shah Sulejmanit, sipas traditës osmane, është varri (mauzoleu) ku gjenden reliktet e Shah Sulejmanit (rrëth 1178–1236), gjyshi i Osmanit I (1323/4), themeluesi i Perandorisë Osmane. Shah Sulejmani besohet të ketë vdekur në lumin Euftrat afër kalasë Qal'at Ja'bar në Raqqa të Sirisë së sotme dhe sipas legjendës ishte varrosur pranë kësaj kalaje, në një varr.

Sipas Traktatit të Lozanës (1923) e cila e copëtoi Perandorinë Osmane në shtetet të reja, në Turqi, Siri dhe shtete të tjera, lokacioni i varrit mbeti pronë e Turqisë. Në nenin 9 të Traktatit të Ankarasë, të nënshkruar nga Franca dhe Turqia në 1921, thuhet se varri i Shah Sulejmanit “do të mbetet, me reliktet e veta, pronë e Turqisë, e cila mund të caktojë kujdestarë (gardianë) dhe mund të ngrit atje flamurin turk. Fillimisht, një garnizon simbolik prej 11 ushtarëve turq ishin duke u kujdesur për varrin.”¹⁵³¹⁵⁴

LONGWOOD HOUSE NË SHËN HELENË

Longwood House është rezidencë në Shën Helena (me shtet sovran Mbretërinë e Bashkuar) dhe paraqet vendbanimin përfundimtar të Napoleon Bonaparte të Francës, gjatë dëbimit të tij në ishullin e Shën Helenës, nga 10 dhjetori 1815.

Pas vdekjes së Napoleonit, Longwood House u kthye tek Kompania e Indisë Lindore dhe më vonë tek Kurora e Mbretërisë së Bashkuar dhe u përdor për qëllime bujqësore. Raportet për neglizhencën e ndërtesës arritën tek Napoleon i III-të i cili, nga 1854, negocoi me qeverinë britanike për transferimin e tij në juridiksion të Francës. Në 1858 ajo u transferua në qeverinë franceze, së bashku me Luginën e Varrit për një shumë prej 7,100 £. Që nga atëherë siti kanë qenë nën kontrollin e Ministrisë së Jashtme Franceze dhe një përfaqësues i qeverisë Franceze ka jetuar në ishull dhe ka qenë përgjegjës për menaxhimin e dy pronave duke u përdorur si muze në pronësi të qeverisë franceze.¹⁵⁵

st-angelo-beside-the-maltese-flag/?lang=en, qasur 29.01.2021.

153 https://en.wikipedia.org/wiki/Tomb_of_Suleyman_Shah

154 <https://www.bbc.com/news/world-middle-east-31574209>

155 <http://www.inside-longwood.com/index.html>, qasur 29.01.2021.





Foto 21: Figura 5 Mali Atos (© OUR PLACE The World Heritage Collection)

MALI ATOS NË GREQI

Mali Athos është një mal dhe gadishull në Greqinë verilindore e cila nuk kategorizohet si zonë eksterritoriale por zonë autonome brenda shtetit sovran të Greqisë.

Mali Athos renditet si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s që nga viti 1988. Një qendër shpirtërore ortodokse që nga viti 1054, mali Athos ka gëzuar një statut autonom që nga kohërat bizantine. 'Mali i Shenjtë', i cili është i ndaluar për gratë dhe fëmijët, është gjithashtu një sit i njohur artistik. Shtrirja e manastireve (rreth 20 prej të cilave

aktualisht janë të banuara nga rreth 1,400 murgj) kishte një ndikim deri në Rusi dhe shkolla e saj e pikturës ndikoi në historinë e artit ortodoks.¹⁵⁶

Megjithëse Mali Atos është legalisht pjesë e Bashkimit Evropian si vet Greqia, ku "Shteti Monastik i Malit të Shenjtë dhe institucionet Athonite" kanë një juridiksion të veçantë e cila u riafirmua gjatë pranimit të Greqisë në Komunitetin Evropian (pararendës i BE-së). Kjo fuqizon autoritetet e Shtetit Monastik për të rregulluar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave në territorin e tij; ku në veçanti, vetëm meshkujt lejohen të hyjnë.¹⁵⁷

¹⁵⁶ <https://whc.unesco.org/en/list/454/>, qasur 29.01.2021.

¹⁵⁷ "Official Journal of the European Communities: L 291 - Volume 22 - 19 November 1979". (2020), <https://eur-lex.europa.eu/>, qasur 29.01.2021.



përfshihen: "aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale;... aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë me objekte ku sipërfaqja e përdhese tejkalon 150m²,... pompat e reja të derivateve të naftës si dhe ndërtimet industriale, fabrikat ose zhvillimet e ngjashme; funksionimi i kazinove, bastoreve dhe veprimtarive tjera të lojërave të fatit;"

Krahas rregullimit të aktiviteteve të ndaluara dhe të kufizuara në ligj parashihet edhe procedura që duhet të ndiqet në rast të ndërhyrjeve në infrastrukturë, sanksionet që pasojnë në rast të dëmtimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore, menaxhimi i pastrimit, lëvizjes së automjeteve, dhe masat mbrojtëse ndaj zjarrit dhe fatkeqësive natyrore.

Në nenin 16 Konsultimi, përcaktohet qartë mënyra e organizimit të procesit, nga paraqitja e kërkesave zyrtare nga palët, deri te trajtimin nga institucionet përgjegjëse, e drejta për konsultime shtesë, dhe roli i institucioneve të nivelit qendror, në rast të ankesës (moratoriumit). Në këtë nen, krahas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit si institucione përgjegjëse, përfshihet edhe roli i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe Këshilli për Zbatim Monitorim (për kontestet që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe).¹⁵⁹

Krahas administrimit të zhvillimeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit, në ligj parashihet edhe themelimi i Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit me qëllim të koordinimit të veprimeve, informimit të publikut mbi rëndësinë dhe statusin dhe promovimin e zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik.

Në qoftë se analizohet në aspekt të parimeve, ky ligj ofron mekanizmin mbrojtës duke përfshirë të tri fushëveprimet: mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, integrimin e kësaj zone të veçantë të mbrojtur në kontekst të planifikimit dhe promovimin e diversitetit kulturor si një mjet për zhvillim të qëndrueshëm lokal e ekonomik. Njëkohësisht në Qendrën Historike të Prizrenit përfshihen vlerat e trashëgimisë kulturore që pasqyrojnë zhvillimin historik dhe ngërthen dëshmi të civilizimeve dhe kulturave të kaluara deri më

sot, ku gjenden edhe një numër i konsiderueshëm i monumenteve fetare ortodokse.

Ngjashëm me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, edhe Ligji (Nr.04/L-62) për fshatin Hoçë e Madhe përcakton masat dhe rregullat e nevojshme që duhet të respektohen me qëllim të mbrojtjes, administrimit dhe zhvillimit bashkëkohor të fshatit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe fetare në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur.

Neni 4 përcakton themelimin e Këshillit i cili do të përfaqësojë interesat e fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe në fushën e planifikimit rural. Më tej nenet 6 dhe 7 përcaktojnë autoritetet e kufizuara lidhur me fushëveprimin e Këshillit, kurse neni 8 paraqet aktivitetet e kufizuara me qëllim të ruajtjes së strukturës dhe karakteristikës së veçantë të fshatit. Gjithashtu edhe në këtë ligj përcaktohet ndarja e përgjegjësisë ndërmjet institucioneve të nivelit qendror (MKRS, Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, MMPH) dhe lokal (Komuna e Rahovecit).

Pas aprovimit të dispozitave ligjore të mësipërme është themeluar edhe njësi të veçantë shumë-etnik të Policisë së Kosovës në mbrojtje të trashëgimisë serbe. Policia e Kosovës në prill 2013 ka themeluar njësinë për Sigurinë e Trashëgimisë Kulturore dhe Objekteve Fetare, me 200 oficerë policorë. Kjo njësi është themeluar në kuadër të Divizionit të Njësive Speciale, përkatësisht në Drejtorinë e Sigurisë së Objekteve dhe Personaliteteve me Rëndësi të Veçantë. Misioni i këtyre 200 anëtarëve të njësive përfshin sigurinë e pjesës së jashtme të trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare. Njësia punon ngushtë me tre komponentë: komunat, stacionet policore dhe prijësit fetarë.¹⁶⁰ Dispozitat e ligjeve të mësipërme të derivuara nga Pakoja e Ahtisarit janë integruar edhe në legjisllacionin e vetëqeverisjes lokale, të planifikimit hapësinor dhe të ndërtimit të Kosovës.¹⁶¹

Në nivelin e planifikimit hapësinor dhe me ndryshimin e Ligjit të realizuar në vitin 2013, Harta Zonale e Kosovës dhe e komunave, si dokumente bëhen pjesë e sistemit të planifikimit hapësinor në të dy nivelet e qeverisjes, edhe atë

¹⁵⁹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 14, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3303>, qasur 20.01.2021.

¹⁶⁰ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, ZBATIMI I MARRËVESHJES SË DIALOGUT POLITIK KOSOVË-SERBI, (Kipred, 2013), http://www.kipred.org/repository/docs/Zbatimi_i_Marr%C3%ABveshjes_s%C3%AB_Dialogut_Politik_Kosov%C3%AB_Serbi_221953.pdf, qasur 29.01.2021.

¹⁶¹ Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor –Neni 12,13,14 -2013; Ligji Nr. 04/L-110 Për Ndërtim-2012; Ligji Nr.03/L-04 Për Vetëqeverisjen Lokale-2008 – Neni 17, Pika (b) ; Udhëzim Administrativ MMPH 12/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksionimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit; Udhëzim Administrativ MMPH 11/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksionimin e Këshillit Për Fshatin Hoçë e Madhe.

Në këtë drejtim, MMPH përmes Institutit për Planifikim Hapësinor dhe strukturave tjera përgjegjëse, në vitin 2019 ka filluar procesin e hartimit të Hartës Zonale të Kosovës dhe ka publikuar draftin e parë të këtij dokumenti. Ky draft përfshin të gjitha dispozitat e kërkuara që derivojnë nga Ligji për Zonat e Vecanta të Mbrojtura.¹⁶²

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

PËR PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI DHE EKSTERRITORIALITETIN

- Normalizimi i plotë i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe njohja reciproke mes dy vendeve është e rëndësishë reciproke për të ardhmen e të dyja vendeve por edhe për stabilitetin dhe zhvillimin demokratik të Ballkanit Perëndimor. Pozita aktuale e shumicës së shteteve të BE-së është se Serbia nuk mund të hyjë në BE pa njohjen e pavarësisë së Kosovës, pa marrë parasysh se nuk ka thirrje publike për atë vendim. Përafrimi me BE-në edhe i Kosovës e edhe i Serbisë duhet të vazhdojë nga tranzicioni aktual drejt normalizimit dhe nga normalizimi drejt bashkëpunimit të plotë ndër-shtetëror në nivele bilaterale dhe multilaterale. Ky proces do të zgjasë, por për një normalizim dhe bashkëpunim të suksesshëm, duhet të shtyhen përpara çështjet që janë të identifikuar mes palëve, ku në mesin e këtyre çështjeve mund të jetë edhe trashëgimia kulturore. Pa njohje reciproke mes dy vendeve, shumë çështje do të mbeteshin "peng" dhe nuk do të kishin epilog të dakordua rmes palëve.
- Pakoja e Ahtisarit, gjegjësisht Aneksi V i cili është integruar në Kushtetutë dhe ligjet përkatëse që janë aprovuar në Kuvend të Kosovës, ka rrjedhur nga një proces politik negociatash dhe kompromis nga pala kosovare në arritjen e pavarësisë së vendit nga Serbia. Ky aneks në thelbin e saj, shihet si një zgjidhje kompromisi për një bashkëjetesë të qëndrueshme, në një kontekst specifik të pasluftës, me dy elementët kryesorë vijues: (I) Njohja e rëndësishë së mbrojtjes dhe ruajtjes së monumenteve dhe lokaliteteve të Kishës Ortodokse Serbe dhe (II) njohja e rëndësishë që kjo të bëhet brenda juridiksionit të Kosovës, duke inkurajuar kështu komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet KOS-it dhe Kosovës. Dispozitat e këtij kapitulli janë integruar në tërë sistemin kushtetues dhe ligjor të vendit, atë për kulturë, planifikim hapësinor, për ndërtim, të drejta fetare, etj. Pjesë e këtij kompromisi ishte edhe njohja e Kishës Ortodokse të Serbisë ndaj institucioneve të reja të vendit të krijuara pas vitit 2008. Është e pakuptimtë dhe

kundërthënëse që kisha të përdor privilegjet që i ofrohen asaj përmes kornizës ligjore dhe në të njëjtën kohë të refuzojë autoritetin e Kosovës e cila ofron këtë kornizë (shembull rasti i fasadimit të Patrikanës së Pejës). Ligjet nuk mund të zbatohen njëanshëm nga asnjë subjekt juridik dhe ato duhet të kuptohen dhe zbatohen në tërësinë e saj kushtetuese dhe legjislative.

- Kushtetuta, ligjet e aplikueshme dhe Strategjia e trashëgimisë Kulturore të Kosovës, ofrojnë bazë të mjaftueshme të sigurisë dhe ato profesionale për të drejtat dhe liritë e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb në mënyrë që të arrihet mbrojtja dhe promovimi i tyre. Për më tepër, këto ligje japin garanci shtesë për Kishën Ortodokse Serbe në autonominë e saj si institucion fetar. Përderisa kategorizimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës, bazohet në kategoritë universale, monumentet e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb kanë gëzuar mekanizma shtesë ligjor, nëpërmjet Ligjit të Zonave të Veçanta dhe mekanizmave që rrjedhin nga ky ligj, ku Kishës Ortodokse të Serbisë i mundësohet mbrojtja dhe gëzimi i privilegjeve dhe imuniteteve, ku përfshihen edhe përfitimet sikurse: ruajtja e pronësisë, liria e plotë e veprimit në menaxhim të pronës, kontrollimin e qasjes për autoritetet e Kosovës, pranimi i donacioneve dhe përkrahjeve nga çdo institucion brenda dhe jashtë Kosovës, dhe privilegjet doganore dhe tatimore.
- Sulmet dhe aktet e vandalizmit ndaj Kishës Ortodokse Serbe janë akte për tu dënuar dhe nuk duhet të ndodhin në një shtet ku funksionin ligji dhe ndëshkimi për vepra penale të kësaj natyre. Sidoqoftë, në Kosovë nuk ekzistojnë të dhëna se një komunitet fetar i organizuar sulmon një komunitet tjetër fetar. Kjo është dëshmuar edhe me raste të ndryshme të punës së përbashkët, konferenca dhe thirrjeve të përbashkëta të liderëve fetarë në vend. Përderisa një grup i organizuar nuk ka marrë përgjegjësi dhe nuk është dënuar, sulme të tilla ndaj Kishës Ortodokse Serbe shpesh raportohen si raste të izoluara nga persona të papërgjegjshëm. Për më tepër, cak i sulmeve



të tilla janë raportuar edhe ndaj komunitetit shumicë myslimane, komunitetit kroat, komuniteteve të margjinalizuara (si LGBT), etj. Ajo çka vlen të theksohet është se të gjithë përfaqësuesit e Kosovës, nga niveli i presidencës, kryeministrit dhe niveli lokal kanë dënuar publikisht aktet e tilla të sulmeve dhe kanë kërkuar qetësi dhe zbardhje e dënim të rasteve.

- Eksterritorialiteti si e drejtë nënkupton kushte, privilegje dhe kompetenca shtesë dhe në raste të caktuara edhe privim nga ligji lokal i shtetit sovran. Ekipit negociator të Kosovës i rekomandohet që të mos pranojë koncesione shtesë, në rast se ngritet tema e eksterritorialitetit në dialogun e ardhshëm për normalizim të marrëdhënieve Kosovë-Serbi - Historikisht, eksterritorialiteti është aplikuar për individët, pasi juridiksioni zakonisht kërkohej mbi njerëzit se sa territoret. Ky parim ligjor për lokalitetet e trashëgimisë kulturore trashëgimisë kulturore aplikohet shumë rrallë dhe në raste shumë të veçanta në botë. Eksterritorialiteti do të cenonte rëndë sistemin kushtetues e ligjor dhe funksionimin e institucioneve e mekanizmave ekzistues pasi që koncesione të tilla veçse janë dhënë gjatë procesit të pavarësisë së Kosovës duke integruar dispozita të veçanta në Kushtetutë dhe ligje përkatëse me diskriminim pozitiv ndaj Kishës Ortodokse Serbe. Në këtë frymë, kjo qasje segreguese ndaj trashëgimisë kulturore të një komuniteti etnik do të ishte kundër vlerave universale që promovojnë kartat ndërkombëtare. Kjo do të krijonte një precedent të rrezikshëm për funksionimin e institucioneve të Kosovës (edhe ashtu të brishta) dhe do t'i minonte të gjitha iniciativat, përkushtimet dhe investimet milionëshe të institucioneve edhe ndërkombëtare në promovimin e trashëgimisë së përbashkët dhe diversitetin kulturor në vend. Në vend të forcimit të mirëbesimit dhe punës së përbashkët mes palëve në proces të dialogut, ngritja e kësaj teme do të mund të shërbente edhe si hapje e "Kutisë së Pandorës" që do të mund të kthente çështjet në "pikën zero" me krijim të atmosferës së mos-besimi e fërkime potenciale ndëretnike ku do të rrezikoheshin edhe të arriturat e deritashme në këtë sektor. Cilado marrëveshje përfundimtare për normalizim të raporteve mes Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë duhet të arrihet brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi, në mënyrë që sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës të mbetet i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Shteti i Serbisë duhet të kthejë artefaktet dhe dokumentacionin arkivor të trashëgimisë kulturore të Kosovë - Kjo

çështje edhe pse ceket në Aneksin V të Pakos së Ahtisarit, nuk ka gëzuar vëmendjen e merituar nga institucionet e Kosovës por edhe nuk ka pasur vullnet nga pala serbe për një proces të tillë. Shans i mirë do të ishte që kjo çështje të trajtohet në kuadër të procesit të dialogut të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

PËR SHTETIN E KOSOVËS

- Trashëgimia kulturore në Kosovë, nuk është prioritet i zhvillimit të vendit ku mungon edhe zbatimi i ligjeve të adoptuara. Përkundër faktit që trashëgimia kulturore konsiderohet të jetë një prej prioriteteve të Qeverisë së Kosovës por edhe përkrahjes së madhe nga partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, gjendja e saj në terren nuk është e kënaqshme. Kjo gjendje është pasojë e kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe profesionale si dhe performanca jo e kënaqshme e institucioneve përkatëse për detyrat që dalin nga legjislacioni në fuqi. Sistemi drejtësisë poashtu nuk ka qenë efikas në dënime të dëmtueseve të trashëgimisë kulturore deri sot.
- Trashëgimia kulturore në Kosovë ka pësuar dëme të mëdha si rezultat i luftës së vitit 1999 dhe trazirave të Marsit 2004. Dëmtimet dhe shkatërrimet ndaj pronave të trashëgimisë kulturore duhet të shihen si pasoja të drejtpërdrejta të konfliktit ku nuk janë kursyer as pronat që me kulturën shqiptare apo edhe islame si dhe ato të komunitetit serb. Me shembujt e ilustruar në këtë hulumtim, vërehet qartë se institucionet e Kosovës dhe në veçanti organizatat ndërkombëtare kanë punuar dhe investuar miliona Euro në sanimin e dëmeve të pasluftës përfshirë edhe projekte restaurimi dhe rindërtimi të kryera pas pavarësisë së Kosovës. Këto investime kanë qenë të nevojshme dhe janë për t'u përshëndetur dhe vlerësuar pasi që kapaciteti ekonomik i Kosovës nuk ka mundur të ballafaqohet me kërkesa të mëdha të këtij sektori.
- Ligji i ri i trashëgimisë kulturore duhet të kalojë përmes një procesi gjithëpërfshirës - Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës duhet të paraqet një qasje të hapur, bashkëpunim të ngushtë dhe përfshirje pro-aktive e Kishës Ortodokse Serbe, si dhe e anëtarëve të KZM-së në proces.
- Aprovimi i konventave ndërkombëtare - Institucionet e Kosovës, duhet të marrin hapa konkret (qoftë edhe të njëanshme) drejt zbatimit të principeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, duke aprovuar dhe zyrtarizuar





Kartat dhe Udhëzuesve të Këshillit të Evropës, të hartuar gjatë projektit të procesit të Promovimit të Diversitetit Kulturor të Kosovës;

- Hartimi i dispozitave ligjore për përcaktim të saktë të Zonave Mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje, dhe përcaktimi i kufizimeve dhe aktiviteteve të lejuara në këto zona është një prej nevojave me prioritet të lartë, që do të ndalonte degradimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, nga zhvillimet e pakontrolluara në zonat mbrojtëse;
- Pasurimi i Listës nën Mbrojtje të Përhershme - Funksionalizimi i procesit të shpalljes nën mbrojtje të përhershme, dhe trajtimi i kësaj çështje me prioritet të lartë. Në këtë pikë ndërlihet roli i KTKK për bashkëpunim me Këshillin Zbatues dhe Monitorues në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe fetare sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
- Qasje gjithëpërfshirëse nga MMPH, dhe përfshirja aktive e MKRS, KOS, dhe Komunave përkatëse gjatë procesit të hartimit të Hartave Zonale për komunat, respektivisht për komunat ku gjenden Zonat e Veçanta të Mbrojtura - Përfshirja e nivelit lokal në perceptimin e kufijve, kufizimeve dhe mundësive të paraqitura me praninë e monumenteve të trashëgimisë kulturore, do të kontribuonte në zbatim të ligjeve përkatëse për mbrojtjen e tyre. Zonat e Veçanta të Mbrojtura nuk duhet të perceptohen si zona të izoluar, por duhet të gjenden mënyra për integrim të tyre në jetën e komuniteteve, gjithmonë duke i respektuar dispozitat për mbrojtjen e integritetit të tyre.
- Aplikimi në UNESCO - Procesi i aplikimit në anëtarësim në UNESCO duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe multi-sektorial dhe jo i mbyllur vetëm në një institucion apo ministri të veçantë. Nevojë imediate është themelimi i grupeve punuese profesionale, që do të përgatisin procesin teknik të anëtarësimit në UNESCO. Inicimi, stimulimi dhe mbështetja e ekspertëve kombëtar për anëtarësim në ICOMOS do të kontribuonte në krijimin e bazës teknike për përgatitjen e nominimeve potenciale në Listën e Trashëgimisë Botërore, duke ngritur edhe vetëdijen në nivel kombëtar.

PËR RAPORTET ME BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE

- Qasja "politikisht jo-korrekte" e UNESCO-s ndaj Kosovës. Nga viti 2000, e sidomos pas trazirave të Marsit 2004 e më tutje, shteti serb ka pasur një qasje shumë pro-aktive në organizatat ndërkombëtare duke avokuar për respektim të frymës së Konventës e Hagës (1954), dhe marrjen e masave ndaj rrezikut që i kanosej trashëgimisë kulturore ortodokse. Në rastin e dëmtimeve të shkaktuara në trashëgiminë kulturore që identifikohet me shqiptarë apo komunitete tjera, një qasje e tillë dhe vëmendje e merituar ka munguar, si nga bashkësitë ndërkombëtare por edhe nga vet pala Kosovare. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në UNESCO ka marrë ngjyrim puro politik, duke u theksuar vetëm pozita e trashëgimisë kulturore dhe fetare e komunitetit serb, por duke u diskriminuar vlerat e trashëgimisë që i përkasin periudhave dhe kulturave tjera. Në këtë aspekt, ky proces duhet të thyejë barrierat e pretendimeve politike mbi sovranitet dhe territor, dhe të shikohet nga këndvështrimi praktikave ndërkombëtare të cilët e zhvendosin trashëgiminë kulturore nga kontrolli ekskluziv i sovranitetit nacional dhe duke e theksuar dhe fokusuar në trashëgiminë kulturore si pronë e përbashkët e të gjithë njerëzimit dhe vlerë e cila duhet të përafrojë komunitetet dhe vendet. Përkundër përvojës së gjatë të bashkëpunimit në nivel teknik dhe profesional ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare (UNESCO, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës), mungesa e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes zyrtare të shtetit të Kosovës në këto instanca, paraqet një disavantazh dhe barrierë në përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të denjë të opinionit profesional e politik në takimet ku trajtohen temat e mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore të larmishme të Kosovës.
- Trashëgimia kulturore në shtetet e ndryshme të botës, kurrë nuk paraqitet si mono-etnike, por shpesh reflekton shtresime të ndryshme kulturore që pasqyrojnë historinë dhe zhvillimin e një vendi. Në kuadër të kësaj trashëgimie apo historie, gjithmonë ekzistojnë kapituj të "hidhur", "të dhimbshëm" dhe kapituj të "krenarisë kombëtare". Kjo nuk i jep të drejtë askujt që këto kapituj "të hidhur" të eliminojë nga narrativa e një vendi. Për këtë arsye, trashëgimia kulturore e Kosovës duhet të trajtohet në plotëni të saj me të gjitha elementet dhe atributet që i ka dhe "ndarja/reduktimi/thjeshtimi apo segregimi" i saj vetëm në një etni apo religjion të caktuar është interpretim i ngushtë e joprofesional dhe nuk i ndihmon fare misionit të përgjithshëm universal të mbrojtjes që promovohet nga UNESCO.





- Mbyllja dhe jo-transparenca e Këshillit për Zbatim dhe Monitorim (KZM). Puna e KZM-së, një trup i përbërë nga MMPH, MKRS, BE, OSCE dhe Kishës Ortodokse Serbe dhe përgjegjëse për monitorimin dhe asistimin e zbatimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, viteve të fundit është karakterizuar me qasje të izoluar dhe ekskluzive.
- Raportet e këtij Këshilli nuk janë publike dhe është vërejtur mungesa e një qasje pro- aktive dhe gjithëpërfshirëse në veprimtarinë e tyre. Përfshirja dhe zbatimi i dispozitave të ZVM duhet të shkojë përtej integritit të këtyre zonave në harta të planifikimit hapësinor, dhe përtej diskutimeve në nivel qendror që zhvillohen në KZM. Në këtë proces përfshirja aktive e autoriteteve të nivelit lokal, niveli profesional dhe i komunitetit, është i domosdoshëm.
- Institucionet e Kosovës bashkë me partnerë tjerë strategjik dhe donatorë ndërkombëtarë duhet të krijojnë mekanizma shtesë financiare për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore në gjithë territorin e Kosovës dhe në shërbim të të gjithëve qytetarëve që jetojnë në Kosovë, përfshirë këtu edhe pronat dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore të komunitetit serb.
- Institucionet e Kosovës bashkë me aktorët tjerë relevantë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të Kishës Ortodokse Serbe duhet të iniciojnë dhe krijojnë mekanizma/trupa profesional të përbashkët në mënyrë që të fillohet me dialog e komunikim në mënyrë që të arrihet një bashkëpunim i mirëfilltë profesional dhe në të njëjtën kohë të arrihet ngritja e mirëbesimit mes palëve - Kjo mund të arrihet përmes krijimit të platformave të diskutimit mes profesionistëve të fushës së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, nga Serbia dhe Kosova; me shkëmbim të eksperiencave mes ekspertëve të Kosovës dhe Serbisë; vizitave reciproke në institucione të trashëgimisë; takime në nivel regional dhe Evropian, etj. Në këtë mënyrë barrierat politike e vendosur rreth këtyre zonave, do të ndihmohet të kalohet përmes urave të bashkëpunimit në nivel profesional;
- Trashëgimia kulturore e Kosovës, përfshirë këtu edhe trashëgiminë e komunitetit serb duhet të jetë më shumë pjesë e narracionit të profesionistëve dhe të komuniteteve sesa e përfaqësuesve politik. Jemi të vetëdijshëm që politika ka pasur, dhe me gjasa do të ketë ende, rol në perceptim të trashëgimisë kulturore me epitete të shpeshta si "e jona" apo "e tyre". Në vend të këtyre epiteteve, duhet të kalohet në narrativën e "trashëgimisë së përbashkët kulturore". Politika duhet të shërbejë për të krijuar kornizë ligjore, garanci për mbrojtje dhe hapësirë të përbashkët për aktorët e ndryshëm (qoftë profesional apo komunitar) dhe ajo nuk është interpretuese apo përcaktuese e vlerave të saja. Institucionet relevante duhet të krijojnë sa më shumë hapësirë për dialog mes komuniteteve dhe profesionistëve të fushës pasi që këta dy faktorë janë përcaktues përfundimtar nëse një lokalitet do të ruhet për gjeneratat e ardhshme.
- Edukimi i brezave të rinj për njohje dhe promovim të trashëgimisë - Të përforcohen shembujt e së kaluarës në promovimin dhe komunikimin e tolerancës ndërfetare. Poashtu të punohet intensivisht në edukim të brezave të rinj të të gjitha komuniteteve (me theks të veçantë shqiptar e serbë) për njohjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore të njëri tjetrit. Kjo arrihet përmes formave të ndryshme të shkëmbimit dhe edukimit alternativ (formal dhe joformal) qoftë edhe me shkëmbim të vizitave në lokalitetet e trashëgimisë së tyre. Pas çdo vizite rekomandohet të organizohen sesione dialogu mes të rinjëve dhe përnjohjes dhe përshtypjes së vizitave ku do të theheshin barrierat e paragjykimet mes tyre.
- Zhvillimi i turizmit, edhe pse në hapa fillestarë do të mund të shërbente si katalizator i përfortimit ekonomik të vendit dhe njëkohësisht të shërbejë si platformë komunikimi dhe e të bërit biznes mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Edhe Kosha Ortodokse Serbe, si pronare e shumë sive të trashëgimisë, e veçanërisht ato të UNESCO-s duhet të jetë pjesë e këtyre proceseve.

PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM:

- Menaxhimi i trashëgimisë kulturore duhet të shkojë përtej mbrojtjes dhe ruajtjes. Ajo është vlerë për zhvillimin ekonomik lokal e shtetëror, jo vetëm si një stimul për turizmin, por edhe në krijimin e mundësive të punësimit në restaurimin, konservimin, menaxhimin dhe promovimin e lokaliteteve të trashëgimisë. Nëse anëtarët e të gjitha komuniteteve janë të përfshirë dhe përfitojnë drejtpërdre-



